



U ORGANIZUA NË PRISHTINË

Edicioni II i Konferencës Kombëtare të Bibliotekonomisë

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës dhe Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë organizuan, më 20 – 22 nëntor 2007, në Prishtinë, Edicionin II të Konferencës Kombëtare të Bibliotekonomisë, me temën: “Biblioteka dhe kujtesa kombëtare”.

Në këtë edicion, i cili u mbajt në mjediset e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, morën pjesë përfaqësues të rëndësishëm të bibliotekave e të bibliotekonomisë - udhëheqës dhe ekspertë të fushave të veçanta, nga Shqipëria dhe Kosova.

Konferencën Kombëtare, që është veprimtaria ndërkombëtare më e rëndësishmja në fushën e bibliotekave që organizohet nga Kosova (BKUK) dhe Shqipëria (BKSH), me temën: “Biblioteka dhe kujtesa kombëtare”, e hapi dr. Sali Bashota, drejtor i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Bashota përshëndeti punimet e kësaj Konferente, duke konfirmuar bindjen se kumtesat dhe debati nga epike ekspertësh nga Tirana dhe Prishtina, gjatë

Konferencës, do të promovojnë iniciativa e ide të frytshme e të vlefshme në përputhje me trendet e reja të zhvillimit të shkencave të informacionit dhe mënyrave të ruajtjes së trashëgimisë kombëtare. Në këtë kontekst foli edhe për rolin dhe misionin e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë dhe Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, në afirmimin dhe ndriçimin e vlerave nacionale në një Projekt të madh siç është ruajtja e Kujtesës kombëtare.

Z. Aurel Plasari, drejtor i Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, përshëndeti pjesëmarrësit në manifestimin solemn të Konferencës, duke u uruar, njëkohësisht, punë të mbarë referuesve dhe pjesëmarrësve që do të përcjellin Konferencën gjatë dy ditëve. Me ndjeshmërinë e rëndësishme që ka trashëgimia kulturore dhe ruajtja e saj, Plasari foli për një proces dinamik të prodhimit të lëndëve kulturore - të përmbajtjeve e formateve të ndryshme, dhe të kërkesës për të ruajtur si të tërë trashëgiminë kulturore nacionale, përkatësisht të kriterëve për përfshirjen e vlerave që duhet ruajtur, duke folur me ndjeshmërinë se si humb shumëçka pa

u arkivuar, nga ajo që krijohet si vlerë kulturore tash, por edhe të asaj të trashëguar.

Konferencën e përshëndetën edhe Agron Gjekmarkaj, përfaqësues i Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Shqipërisë, si dhe Shkurte Kadriu, udhëheqëse e departamentit për Bibliotekat në Ministrinë e Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Çështjeve Jorezidentente.

Gjatë dy ditëve të Konferencës, me temën: “Biblioteka dhe kujtesa kombëtare”, kumtesat e referuesve ishin të përqendruara në fusha specifike me të cilat ata merren, përkatësisht në frymën e preokupimeve të tyre që lidhen me përgjegjësitë, menaxhimin dhe dijet specifike. Pra, njohësit më të mirë - me formim kulturor dhe bibliotekar - nga Shqipëria dhe Kosova, referuan, duke analizuar praktikat, por dhe vizionit për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e trashëgimisë kulturore kombëtare, në përputhje me zhvillimet e reja të teknologjive dhe të shkencës së bibliotekave dhe informacionit.

Projekt-rezolutë e Konferencës Kombëtare të Bibliotekomisë (Edicioni II)*

Konferenca edicionin e saj të dytë e zhvilloi nën temën Biblioteka dhe Kujtesa Kombëtare, nga data 20-22 nëntor 2007, në mjediset e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës në Prishtinë.

Bazuar në gjendjen konkrete të bibliotekave për mbledhjen, dokumentimin dhe ruajtjen e kulturës kombëtare, pjesëmarrësit miratojnë rezolutën e mëposhtme:

- Bibliotekat shqiptare në Kosovë dhe Shqipëri i realizojnë detyrat e tyre funksionale në kushtet e shoqërive të reja demokratike përkatëse.
- Problemi i funksionimit të bibliotekave në kushtet e përkushtimit për krijimin dhe ruajtjen e kujtesës kombëtare, në kushte të reja të shoqërisë digjitale, është esencial për ecurinë e këtyre institucioneve të rëndësishme të kulturës së librit.
- Konferenca theksoi rëndësinë e rishikimit të kuadrit ligjor në fushën e bibliotekave dhe trashëgimisë kulturore, ripërcaktimit të rolit të bibliotekarëve në kushtet e shoqërisë së informacionit, përzgjedhjes dhe ruajtjes së dokumenteve dhe informacioneve burimore në çdo lloj forme, të cilat paraqesin identitetin kombëtar.
- Konferenca nënvizoi gjithashtu se qartësimi i problemeve dhe ndërjegjësimi teorik për aspekte themelore që kanë të bëjnë me proceset dhe llojet e organizimit dhe të përpunimit të koleksioneve nacionale, janë kërkesë e domosdoshme për shkëmbimin e informacioneve Shqipëri-Kosovë.
- Bibliotekat tona mbështesin plotësisht nismat e Këshillit të Evropës për ndërtimin e Bibliotekës Digjitale Evropiane, si të gjitha Manifestet e IFLA-s, UNESCO-s për ruajtjen e trashëgimisë kulturore.
- Përdorimi i teknologjisë së informacionit duhet të shihet si mjet për rritjen e efek-

tivitetit dhe të nivelit të ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe të shërbimit ndaj përdoruesve.

- Bashkëpunimi në veprimtarinë informuese bibliografike dhe në krijimin e bazave të të dhënave do të krijonte më shumë mundësi për shkëmbimin e informacionit dhe përdorim të përbashkët të burimeve.
- Epoka e informacionit kërkon forcimin e rolit të bibliotekarit si mediator dhe kujdestar i ruajtjes së materialeve dhe informacionit për përdoruesit, në këtë kontekst edhe të edukimit të vijueshëm profesional i tij.
- Organizimi i veprimtarive të përbashkëta në këtë fushë si edhe përditësimi me teorinë dhe praktikën bashkëkohore të bibliotekomisë, duhet të shihet si domosdoshmëri për t'u përshtatur me rrjedhat e kohës.

Për të arritur sfidat e parashtruara duhet të punojmë të gjithë së bashku për:

- 1) forcimin e rolit të bibliotekave si mbështetëse të trashëgimisë, demokracisë dhe të lirisë intelektuale e të aksesit në informacion;
- 2) grumbullimin e kujtesës kombëtare;
- 3) zhvillimin e kulturës së leximit si mjet i pazëvendësueshëm në edukim, kulturë e shkencë;
- 4) krijimin e mjediseve të përshtatshme digjitale për të gjitha kategoritë e përdoruesve;
- 5) zgjerimin e përdorimit të teknologjisë së informacionit me synim rritjen e aksesit në shërbimet dhe burimet bibliotekare;
- 6) rritjen e besimit dhe sigurisë në përdorimin e teknologjisë nga përdoruesit;
- 7) respektimin e normave të etikës kulturore, profesionale dhe të komunikimit.

Prishtinë, më 22 nëntor 2007

** Pjesë nga Projekt-rezoluta e hartuar në Prishtinë në Konferencën Kombëtare të Bibliotekomisë (Edicioni II): "Biblioteka dhe Kujtesa Kombëtare"*

Në këtë numër



Biblioteka dhe Kujtesa Kombëtare.....4

Intervista referale: teori dhe praktika...6

Pesë intervista referale: një vështrim hulumtues8

Libri shqip në Kosovë (1944 - 1984)12

Tematika dhe konteksti sociokulturor i botimeve në Kosovë.....14

Biblioteka në fiksionet e Borges-it.....20

BIBLIOTEKA
KOMBËTARE
DHE UNIVERSITARE
E KOSOVËS



THE NATIONAL
AND UNIVERSITY
LIBRARY
OF KOSOVO

www.biblioteka-ks.org

Botues: BKUK • **Kryeredaktor i botimeve:** Prof. dr. Sali Bashota

Kryeredaktor: Fazli Gajraku

Këshilli redaktues: Besim Kokollari, Bukurije Haliti

Realizimi kompjuterik: Extreme Studio

Fotoreporter: Bashkim Binaku

Adresa: Sheshi "Hasan Prishtina", p.n. Prishtinë

Tel: ++381 38 225-605, **Fax:** ++381 38 248-940 • **e-mail:** biblioteka@biblioteka-ks.org

U ORGANIZUA NË PRISHTINË

Edicioni II i Konferencës Kombëtare të Bibliotekonomisë

/ vijon nga ballina /

Nëpërmjet këtyre referimeve, provuan të japin rrugët në sfidat me të cilat po ballafaqohen bibliotekat në këtë epokë - në kushtet e rritjes së botimeve të llojeve dhe formateve të ndryshme, si dhe të kriterit për përzgjedhjen, grumbullimin dhe ruajtjen e dokumenteve me vlerë kombëtare.

Konferenca, gjithashtu, ishte në nivelin e dhënies së përgjigjeve edhe në kuptimin teorik, për mbledhjen, ruajtjen, menaxhimin, si dhe përpunimin e digjitalizimin e koleksioneve të rëndësishme të veçantë kombëtare.

Konferenca ka prekur ndjeshëm edhe çështjen e nevojës për bashkëpunim, shkëmbim të informacioneve dhe të koleksioneve të bibliotekave nga Shqipëria dhe Kosova. Takimet gjatë konferencës përforcuan bindjen për një bashkëpunim më të konsoliduar dhe shkëmbimi të informacionit dhe të ideve. Tashmë këto takime po japin shenja të qarta të motivueshme për ndërtimin e politikave të përbashkëta në shumë nga fushat që kanë të bëjnë me ruajtjen dhe zhvillimin e koleksioneve nacionale.

Temat e referuesve zgjuan interesim të pjesëmarrësit, por edhe të mediave të shkruara dhe elektronike, duke pasur parasysh jo vetëm rëndësinë e temës bosht: *Biblioteka dhe kujtesa kombëtare*, por edhe të referimeve për këto probleme nga njohës të fushave specifike, nga Kosova dhe Shqipëria, që kanë të njëjtat sfida për ruajtjen e kujtesës kombëtare.

Gjatë konferencës pjesëmarrësit dëshmuuan përshirjen e tyre në këto preokupime, duke provuar suksesin e tyre dhe të institucioneve që përfaqësojnë, për të dhënë ide dhe strategji



Pamje nga hapja solemne e Konferencës Kombëtare të Bibliotekonomisë

konkrete veprimi në planet e ardhshme të zhvillimit të bibliotekave.

Gjatë dy ditëve të punimeve të Konferencës Kombëtare të Bibliotekonomisë me temën: "Biblioteka dhe Kujtesa Kombëtare", u lexuan kumtesa: "Kosova në shek. XVII sipas relatorëve të Papatit (Gjon Berisha), "Bibliotekat digjitale dhe kujtesa kombëtare" (Etleva Domi), "Ruajtja dhe zhvillimi i koleksioneve të veçanta në BKUK" (Muharrem Halili), "Arritje dhe mundësi të reja të ndriçimit të fondeve të rralla të Bibliotekës Kombëtare" (Mejli Kokona), "Bibliotekat e para në Prizren dhe librat e vjetër" (Sahadete Sadikaj), "Hartat e shek. 16-19, pjesë e kujtesës kombëtare (Afërdita Sharxhi)", "Konsekuencat e mosdokumentimit në Kosovë, apo kërkimi i të humburës" (Fazli Gajraku), "Libri shqip i dekadave të para të shtetit shqiptar: dukuri dhe probleme bibliotekonomike sipas bibliografisë retrospektive" (Maksim Gjinaj), "Letërsia shqiptare e Kosovës 1835-2005: vështrim bibliografik" (Tahir Foniqi), "Digjitalizimi i skedarëve të koleksioneve të dorëshkrimeve dhe të librave të rrallë të fondeve Al-Ba dhe integrimi i tyre në Web-in e Bibliotekës Kombëtare" (Behije Luga, Mirlona Buzo), "Biblioteka digjitale në shërbim të kujtesës kombëtare" (Ramush Zeka, Besim Kokollari), "Krijimi i sistemit të përbashkët të informacionit për vlerat kulturore duke shkruar drejt

unifikimit të katalogimit" (Marjeta Daci), "Përpjekjet dhe strategjia e zhvillimit të katalogut të përbashkët të bibliotekave në Kosovë" (Bukurije Haliti), "Konvertimi retrospektiv - sfida dhe arritje" (Mirela Mersini, Teuta Sula), "Trashëgimia kombëtare e shkruar dhe publiku" (Ramazan Vozga), "Fotografia-dëshmi e kujtesës kombëtare" (Jetish Kadishani), "Zhvillimi i koleksioneve në bibliotekën publike dhe menaxhimi i tyre (Sylejman Pireva), "Koleksionet lokale, pjesë e kulturës kombëtare" (Gjovalin Çuni), "Ekzemplari i detyrueshëm dhe ruajtja e trashëgimisë kombëtare në Kosovë" (Lavdiqe Rrahmani), "Animimi i krijuesve dhe përdoruesve për bibliotekat e muzikës (Edona Munishi - Kokollari), "Bibliotekat private, pjesë e trashëgimisë kulturore kombëtare" (Violeta Viso), "Trinomi bibliotekë, arkiv, muze dhe kultura kombëtare" (Farfuri Xhaja, Alda Biçoku), "Ruajtja e trashëgimisë kulturore botërore - projekti Kujtesa e Botës" (Tefta Buzo).

Me rastin e organizimit të Konferencës, gjatë dy ditëve qëndroi e çelur edhe ekspozita: *"Kuteli në 100 vjetor"* e përgatitur nga specialistët e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, në kuadër të Vitit jubilar "Kuteli" - për nder të 100-vjetorit të lindjes së shkrimtarit të madh. Po ashtu, nga Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës u organizua ekspozitë me tituj dhe formate të ndryshme të përzgjedhura, me titull: *Koleksione të Veçanta të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës*

Në fund u hartuan dhe u miratuan Konkluzionet e Konferencës, të cilat, para pjesëmarrësve, i kumtoi - Etleva Domi, zëvendës drejtoreshë e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë.

Bukurije Haliti



Pjesëmarrës në hapjen e Konferencës Kombëtare të Bibliotekonomisë

Biblioteka dhe Kujtesa Kombëtare

PROF. DR. SALI BASHOTA, DREJTOR I BKUK-SË

Rëfimi për një Bibliotekë nacionale mund të sajohet nga shumë fjalë të zgjedhura, të urta, mbase, jo rrallë, edhe të shenjta, të shndërruara në histori apo në gojëdhënë. Kujtesa e saj apo kujtesa për të, mund të shndërrohet, gjithashtu, në një simbol komunikimi me të tjerët dhe prapë do të mbetet si gjithnjë vetëm historia e Librit dhe e Bibliotekës.

Siç është e njohur, tekstet në formën e shkruar e sajojnë dhe i përgjigjen gje-nealogjisë së një kombi dhe të një civilizimi, prandaj çdo popull identitetin e vet e fillon me shkrimin, pra me datëlindjen e shkrimeve të para në gjuhën e tij.

Në këtë kontekst, Biblioteka, si vend i shkrimeve, i dorëshkrimeve, i librave të moçëm e të rinj, i hartave, i fonodokumenteve, i fotodokumenteve dhe i koleksioneve të tjera, e prodhon vetë në kujtesën e shekujve historinë e njerëzimit në periudha të caktuara, madje edhe historinë e fjalës së shkruar.

Tani kujtesa, lidhet me shkrimet e vjetra që u nevojiten gjeneratave të reja.

Biblioteka dhe Kujtesa Kombëtare, që është caktuar temë kryesore për debat dhe ligjërime në edicionin e dytë të Konferencës Kombëtare të Bibliotekonomisë, organizuar nga Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës dhe Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, me kontributet e ekspertëve të bibliotekave shqiptare, mund të ofrojë një prezantim mjaft të rëndësishëm dhe me interes shkencor e kulturor, pikërisht në iniciimin, zhvillimin, realizimin e një projekti madhor, që do të mund të quhej Kujtesa Shqiptare.

Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë dhe Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, si iniciues të mundshëm të këtij projekti të përbashkët nacional me emrin Kujtesa Shqiptare, doemos, do të kenë rolin kryesor në grumbullimin, seleksionimin, sistemimin dhe digjitalizimin e materialeve të veçanta, për t'iu ofruar lexuesit një qasje të lirë në botën e internetit, sidomos për të kaluarën dhe të ardhmen e shqiptarëve, nëpër periudha të ndryshme historike.

Po kështu, Kujtesa Shqiptare, si e tillë, do të mund të përmbledhte imagjinatën e shkrimtarëve, artistëve, teorici-



Foto nga hapja solemne e Konferencës Kombëtare të Bibliotekonomisë

enëve, filozofëve, psikologëve, shkencëtarëve etj., pikërisht atë imagjinatë kreative të shndërruar në vepra të dijeve të ndryshme, që do ta përbënte një bibliotekë, doemos, me idetë dhe mendimet që, po ashtu, do të funksiononin përmes gjuhës së komunikimit, në shumë rrafsh-receptimi.

Kudo në botë, bibliotekat nacionale të çdo shteti, i kanë format e veta të mbledhjes së materialeve të dokumentuara, qoftë të trashëgimisë së shkruar, qoftë të trashëgimisë gojore, për t'i dhënë prioritet historisë, gjuhës, kulturës etj., për të ndërtuar një Depo Qiellore, që e ka kuptimin e Gjithësisë, siç do të thoshte Umberto Eco.

Prandaj, në këtë Depo Qiellore, përparësi do të kenë materialet me vlerë të veçantë dhe unikate nacionale, që do ta dokumentonin lashtësinë, gjuhën, identitetin, qytetërimin, kulturën etj.

Historia e një kombi, nuk mund të njihet, të shkruhet a të rishkruhet, madje të vlerësohet pa thesarin a trashëgiminë e një biblioteke nacionale të atij vendi, duke iu rikthyer vazhdimisht kujtesës kombëtare në fazat e zhvillimit të asaj kulture a qytetërimi të lashtë të popullit që i takon.

Biblioteka e humbur, si ajo e Aleksandrisë apo Biblioteka e pushtuar, madje edhe me fondet e saja të asgjësuar në dhjetëvjetëshin e fundit të shekullit XX, siç është Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, si dhe shumë biblioteka të tjera në botë, e kanë krijuar ekzistencën dhe historinë e tyre, në variante të ndryshme të gjëllimit.

Mirëpo, përbrenda plotnisë së identitetit dhe kulturës kombëtare, rrugëtimi

ynë historik, i veçantë dhe i përbashkët, kuptohet me kufi të ndarë, nuk ka qenë i njëjtë, pra ka qenë i ndryshëm, prandaj edhe kujtesa e lexuesit shqiptar, iu është nënshtruar, herë diktatit e ideologjisë, herë anatemimit e pushtimit.

Pra, kështu ka ndodhur edhe me kujtesën e lexuesit për një letërsi nacionale, siç është letërsia shqipe, kur ajo madje është ndarë në përparimtare e reaksionare. Pra, kështu ka ndodhur me personalitetet letrare: Fishta, Konica, Koliqi, Harapi, Pllumi, Pipa etj.

Ekziston kujtesa e lexuesit nëpër kohë dhe hapësirë të caktuar, e cila do të dëftonte se tekstet e shtypura, librat e moçëm, filmat, fotografitë etj., të grumbulluara, të ruajtura, të sistemua dhe së fundi të prezantuara para opinionit, kanë rëndësi të madhe në ndriçimin e asaj që quhet kujtesë nacionale në retrospektivë, por edhe në perspektivë.

Në këtë pikëshikim, historia dhe kultura shqiptare në Kosovë dhe Shqipëri, edhe pse e një shtrati gjenetik, është zhvilluar përbrenda konteksteve të ndryshme shoqërore e politike, jo rrallë, është fragmentarizuar e çintegruar deri në absurditet, duke mbetur, jo rrallë, vetëm si kujtesë shpirtërore nga distanca.

Kujtesa Shqiptare është sajuar me përplot absurde dhe paradokse, sidomos në gjysmën e dytë të shekullit XX, kur ka kaluar nëpër periudha fatkeqësie përbrenda kontekstit ideologjik (në Shqipëri) dhe pushtues (në Kosovë). Tani dokumentimi dhe prezantimi digjital i kësaj Kujtese kërkon një hulumtim shkencor, pikërisht në ndriçimin e kësaj periudhe tepër të dhembshme.

Në anën tjetër, Kosova nuk ka ndonjë traditë të lakmueshme, sa i përket grumbullimit dhe ruajtjes së dokumenteve më rëndësi nacionale, për arsye se fati dhe perspektiva e saj është varur nga të tjerët. Në periudhat e pushtimit të saj, sidomos në luftën e fundit, janë shkatërruar, djegur, zhdukur shumë thesare të çmueshme dhe me rëndësi të veçantë kombëtare, por edhe monumente historike e kulturore me vlerë të jashtëzakonshme, të cilat do të tregonin për identitetin shqiptar të saj.

Në dhjetëvjetëshin e fundit të shekullit XX, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, si dhe shumë biblioteka tjera publike dhe private në Kosovë, kanë përjetuar fate të tmerrshme. Derisa në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës brenda viteve 1991- 1999, janë asgjësuar mbi njëqind mijë ekzemplarë librash të ndryshëm dhe janë shndërruar në kartuç në një fabrikë letre në një qytet të vogël të Kosovës, shumë biblioteka publike dhe private janë rrënuar, shkatërruar dhe djegur. Prandaj, djegia e librave dhe e bibliotekave në Kosovë, është njëri ndër kapitujt më të dhembshëm, nga mund të rrefehet për përmasat e luftës në Kosovë.

Në vitin 2006, Biblioteka dhe Universitare e Kosovës, e ka inicuar projektin Kujtesa e Kosovës, sipas modelit American Memory (Kujtesa Amerikane), i Bibliotekës së Kongresit, i cili synon të jetë njëri ndër projektet më kapitale që mund të determinojë rolin dhe misionin e historisë, kulturës, qytetërimit, identitetit, shëmbëlltyrave, personaliteteve, trashëgimisë gojore, trashëgimisë së shkruar në periudha të caktuara historike, me qëllim të prezantimit të kësaj kujtese përmes informacioneve digjitale.

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, duke e filluar këtë projekt, do të bëhej, gjithsesi, një pikë e veçantë referimi, bashkë me institucionet tjera (muzetë, arkivat, institutet etj.), për të krijuar një koleksion dokumentar, qoftë madje edhe për ngjarjet politike, shoqërore që nuk i përkasin vetëm burimeve të komunitetit kosovar, por edhe më gjerë, që ndërlidhen pikërisht me çështjen shqiptare në kohë dhe periudha të ndryshme.

Në strategjinë e realizimit të një projekti gjithëpërfshirës për themelimin e koleksioneve digjitale të Kujtesë së Kosovës, e cila faktikisht është njëra nga portat e Kujtesës Shqiptare, është më

rëndësi krijimi i fondeve nga burime qeveritare dhe alternative, si dhe bashkëpunimi me institucione të shumta në botë, që i posedojnë dokumentet shqiptare dhe për shqiptarët.

Po kështu, prioritet do të mund të kenë: koleksionet për personalitetet nacionale me përmasa botërore, siç janë Skënderbeu dhe Nënë Tereza, pastaj koleksionet e librave të rrallë dhe të vjetër, koleksionet e hartave, fotodokumenteve, fonodokumenteve etj.

Në grumbullimin e materialeve me vlerë, në sistemin, përzgjedhjen dhe krijimin e koleksioneve digjitale, rol të rëndësishëm do të ketë informacioni për historinë gojore dhe historinë e shkruar. Në këtë drejtim, kontributi i arkivave, i muzeve, i institucioneve historike, akademike, albanologjike, etnografike në Kosovë, Shqipëri, në viset tjera shqiptare, pastaj në ish-kolonitë shqiptare në Turqi, Itali, Rumani, Bullgari, Egjipt, Amerikë etj., do të ishte me rëndësi të dorës së parë.

Cilat do të ishin burimet për krijimin e një koleksioni digjital kombëtar në të ardhmen?

Natyrisht, në këtë drejtim do të mund të kenë rol të rëndësishëm shumë pjesëmarrës: gjithsesi, Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, pastaj Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, pastaj arkivat, muzetë, institutet, institucionet fetare në Shqipëri dhe Kosovë. Në këtë drejtim, themelimi dhe funksionimi i bibliotekave presidenciale, i bibliotekave të personaliteteve apo i bibliotekave private etj., do të kontribuonin në afirmimin dhe ndriçimin e vlerave nacionale nëpër periudha të ndryshme të historisë.

Njihen raste të ndryshme në botë ku shumë biblioteka janë shkatërruar dhe nuk janë ruajtur më, ku shumë biblioteka janë djegur dhe nuk janë ndërtuar më. Biblioteka përmes ndriçimit të kujtesës kombëtare, e funksionalizon të kaluarën me të tashmen, duke dhënë vizion për të ardhmen.

Sa i përket gjendjes në bibliotekat e Kosovës, ende në bibliotekat tona mungojnë shkrimet, zërat për figurat e shquara të kombit shqiptar, për personalitetet kulturore, politike, pastaj mungon historia e largët dhe e afërt e Kosovës. Pra, mungon përmbajtja, si dhe ndërtimi i Kujtesës së Kosovës.

Pra, mungojnë burimet historike, trashëgimia kulturore, dorëshkrimet e lashta, dorëshkrimet origjinale, mungon

pjesa e historisë së Kosovës, e cila do të mund të gjendej në arkiva dhe biblioteka të Evropës.

Në këtë mënyrë, strategjia e zhvillimit të bibliotekave shqiptare ndër të tjera, e nënkupton edhe funksionalizimin e kujtesës nacionale përmes një diskursi të ri të shkencës së bibliotekarisë dhe të informacionit. Pra, e reja duke iu rikthyer të vjetrës, do t'i gjejë prioritetet e afirmimit të vlerave elitiste nacionale nga momentet historike në momente të aktualitetit.

Debati ynë këtu, me ekipe ekspertësh nga Tirana dhe Prishtina, në relacionin Biblioteka dhe Kujtesa Kombëtare, është një kërkim pasionant, dashurues e shumë domethënës, jo vetëm për dy bibliotekave tona qendrore, që e kanë fundja shenjën e përbashkët nacionale, por edhe për bibliotekat shqiptare në përgjithësi, për ato private, shkollore, universitare, shkencore, akademike etj.

Projekti për funksionalizimin dhe digjitalizimin e Kujtesës Shqiptare, tashti në rrjetin global të Kujtesës Botërore, do ta funksionalizonte një kujtesë të fuqishme nacionale, qytetëruese e kulturore, fjala vjen, po t'i kishte të gjitha librat a dokumentet e shkruara e të botuara për Skënderbeun dhe Nënë Terezën, si dhe për personalitetet tjera të njohura në përmasa botërore në periudha të ndryshme, për të dokumentuar ekzistimin e civilizimit shqiptar në mijëvjeçarë, duke iu referuar edhe koleksioneve të shumta albanologjike, të pranishme në jo pak biblioteka, arkiva, muze në botë.

Besoj dhe shpresoj se kjo Konferencë, do të iniciojë shumë ide të frytshme e të vlefshme, si dhe do të sjellë rezultate të caktuara në fushat e hulumtimit, përkritazi me temën bosht. Natyrisht, mbështetja e institucioneve qeveritare në Kosovë dhe Shqipëri, për projekte të këtilla me interes të veçantë nacional, do të ishte e ardhmja e kulturës, e librit dhe e bibliotekave shqiptare në përgjithësi.

Uroj punë të mbarë, pjesëmarrësve të Konferencës Kombëtare të Bibliotekonomisë në Prishtinë. Suksese në projektet tona të përbashkëta, siç do të jetë edhe kontributi ynë në inicimin, zhvillimin dhe realizimin e projektit: Kujtesa Shqiptare.

(Fjalë hyrëse, me rastin e organizimit të Edicionit të dytë të Konferencës Kombëtare të Bibliotekonomisë, me temën: Biblioteka dhe Kujtesa Kombëtare, Prishtinë 20 nëntor 2007)

Intervista referale: teori dhe praktika



STEPHANIE WILLEN BROWN

/ Vijon nga numri i kaluar /

Po japim më poshtë një përshkrim të përmbledhur të pesë fazave të intervistës referale, mbështetur në shembullin e mëhershëm të “informacioneve për kancerin e gjirit”, kjo do të na ndihmojë se si të pestë elementet e intervistës referale funksionojnë në praktikë. Mund të filloj të bëj një vlerësim fillestar me rastin kur përdoruesja i ofrohet tavolinës së referencës: nëse ajo do të ishte 15-vjeçe dhe nëse unë do të isha në shërbim në një bibliotekë publike, do të mendoja se ajo nuk është duke shkruar një temë disertacioni. Do ta krijoja kontaktin e drejtpërdrejtë me sy dhe do të shprehja interesin tim në temën e “kancerit të gjirit”. Në fazën e tretë, do të bëja ca pyetje sqaruese si “çfarë lloji të informacionit jeni duke kërkuar?” Po qe se përdoruesja nuk do të ma kuptonte pyetjen, do të pasoja pyetjen tjetër duke i thënë “a deshët materiale shkencore apo ndoshta diçka më të lehtë për t’u kuptuar?” Pa marrë parasysh përgjigjen në këtë pyetje, mbase do të pyesja më pas “më tregoni se çfarë informacione keni gjetur deri më tani” kështu që s’do të përsërisja gjënë e njëjtë të cilën e ka bërë përdoruesja - që do ta mërziste atë. Pastaj do të mendoja për disa baza të të dhënave të dobishme, të cilat do t’i hynin në punë përdoruesit - kjo do të ishte kata-

logu elektronik për të gjetur libra, PubMed (bazë e të dhënave) për të gjetur artikuj shkencorë nga mjekësia, apo ndonjë bazë të përgjithshme të të dhënave - si Academic Search Premier, për të gjetur artikuj të përgjithësuar, të përshatshëm për të bërë një punim për studentët në studime themelore apo për studentët të cilët nuk e studiojnë mjekësinë. Do t’i ndihmoja përdorueses të gjejë disa artikuj të dobishëm dhe do të sigurohesha se ajo tash di se si të bëjë kërkime të mëtejshme. Së fundi, do ta përfundoj intervistën time me ofrimin e informacionit kontaktues po qe se do ta kisha parandjën se ajo do të ketë nevojë për të më parashtruar pyetje shtesë më pas; po qe se do të isha në tavolinën e reference, do t’i tregoja se deri kur do të mund të më gjente aty dhe ta inkurajoja të më kontaktoj mua apo bibliotekarët e tjerë referalë po qe se do të ketë pyetje shtesë.

PROBLEMET ME PYETJET E PËRDORUESVE

Bill Katz, mësimdhënës i shkencave të bibliotekarisë për një kohë të gjatë, si dhe redaktor i librit *Hyrje në punën e referencës (Introduction to Reference Work)* ofron disa rregulla për bibliotekarët të cilët përpiqen t’u ndihmojnë përdoruesve¹. Dy nga këto rregulla paraqesin elemente thelbësore për t’u ofruar përdoruesve një përvojë të mirë referale:

1. Je skeptik sa i përket informacionit të cilin e paraqet përdoruesi
2. Provo terma të ndryshëm kërkues

Kujtesa e njeriut mund të gabojë, kështu që është e rëndësishme që të jemi të vetëdijshëm për hollësitë të cilat i ofron përdoruesi. Për shembull, njëherë më ka ndodhur t’i ndihmoj një studenti i cili e kërkonte një artikull të cilin ia kishte sugjeruar profesori për ta lexuar. Studenti me tha që artikulli ishte në një

numër të revistës *The Behavioral and Brain Sciences* e botuar kah fundi i viteve të 1980-ta. Studenti më pyeti se ku gjendej e vendosur revista kështu që ai mund ta shfletonte atë. Duke e ditur që data e botimit mund të ishte gabim (dhe duke shpresuar që emri i revistës ishte i saktë), e këshillova studentin që të shfletojë disa numra, e jo vetëm ato të botuara ka fundi i viteve të 1980-ta. Isha kureshtar se si do të shkonte ky kërkim, kështu që i kërkova studentit të kthehej dhe të më tregonte se ku e kishte gjetur me të vërtetë artikullin - dhe po qe se nuk do ta gjente, i thash se do ta ndihmoja që ta gjente me disa mënyra të tjera². Emri i revistës kishte qenë i saktë, mirëpo artikulli ishte botuar në një numër në vitet e hershme të viteve 1990-ta. Problemi me data paraqitet vazhdimisht gjatë punës sime si bibliotekare referale, dhe ndërsa gjatë punës sime si mësimdhënës gjithmonë ua theksoj faktin studentëve të mi që të jenë të kujdesshëm për hollësitë specifike të cilat i ofron përdoruesi: fillo me informacionin që ta ofrojnë, por përgatitu që të zgjerosh periudhën e datës së dhënë, kontrollo drejtshkrimin, apo ndrysho ca fjalë.

Lidhur me këtë, Katz sugjeron të përdorim terma të ndryshëm kërkimi gjatë procesit të kërkimi si në katalogët e librave po ashtu edhe në bazat e ndryshme të të dhënave në internet. Ne duhet t’i marrim termat kërkues të përdoruesit dhe të mendojmë për sinonime apo terma të tjerë të mundshëm për temën e tyre. Së voni i kam ndihmuar një studenteje, e cila po bënte një hulumtim sa i përket “identitetit gjinor” për lëndën e sociologjisë. Ne bëmë kërkimin me këtë togfjalësh në një bazë të veçantë të sociologjisë të quajtura ‘*Sociological Abstracts*’ dhe gjetëm përfaqësisht 1000 artikuj. Mjaft shumë në dukje të parë, por mendja më thoshte se duhet të kishte shumë më shumë artikuj se kaq sa i përket kësaj teme. E vërejtja një përcaktuese lëndore në një artikull të dobishëm që

¹ Katz, William A. *Introduction to Reference Work, Volume II “Reference Services and Reference Processes.”* Sixth Edition. New York : McGraw-Hill, ©1992. I parafrazuar në f. 82.

² Vërej këtë shembull të përcjelljes së progresit të përdoruesit, siç sugjerohet në udhëzimet e Shoqatës për Shërbime Referale dhe për Përdorues.

thoshte “roli i identiteti gjinor”. Përdoruesja u pajtua se ky togfjalësh dukej mjaft i ngjashëm dhe i dobishëm me temën në fjalë, dhe kur kërkuam me të, arritëm të nxjerrim mbi 2,500 artikuj – dy herë më shumë se sa kërkimi fillestar që e kishim bërë. Në këtë shembull, përdoruesja do të kishte gjetur materiale të cilat janë “mjaft të mira” me anë të kërkimit të saj fillestar, por për të bërë një kërkim më të gjerë, ajo duhej ta ndryshonte paksa termin kërkues. Unë ua shpjegoj këtë koncept përdoruesve, duke e bërë një analogji gjuhësore: përdoruesit e dinë se çfarë do të thotë termi i tyre kërkues, mirëpo baza e të dhënave në të cilën bëhet kërkimi mund të ketë në përdorim një terminologji tjetër sa i përket temës. Atëherë kur ata e kuptojnë se si e quan baza e të dhënave atë term kërkues, ata janë të gatshëm për të bërë hulumtime më të hollësishme.

Intervista referale është proces ndër-mjetësues mes pyetjes së përdoruesit dhe burimit ideal që do t'i jepte përgjigje asaj pyetje. Në librin e tyre “Shërbimet Referale dhe të Informacionit në shek. XIX” (Reference and Information Services in the 21st Century), Kay Ann Cassell dhe Uma Hiremath shprehën:

“Intervista referale është më shumë art se sa shkencë, një praktikë që ndryshon vazhdimisht e që kërkon më shumë reagim në kontekst të caktuar sesa zbatim të shkathësive të paracaktuara. Përderisa bibliotekarët duhet të mësojnë elemente të një interviste të mirë referale, ata duhet po ashtu të dinë që këta hapa duhet t'i përshtaten çdo situatë të veçantë”.

Ky koment është sa i mençur aq edhe i vërtetë. Në praktikë, nuk bëj gjithmonë pyetje provuese në fillim të intervistës referale; shpesh i qasem drejtpërdrejt pyetjes së përdoruesit. Mirëpo, duhet të kam vullnetin ta ndryshoj qasjen time për arsye se disa përdorues mund të mos jenë të kënaqur me përgjigjen e ofruar sa i përket pyetjes së tyre fillestare, të cilën e parashtrajnë. Për shembull, një përdorues më pat pyetur nëse kishim libra të quajtur “Excel VBA”. Fillova të shikoja për librin të

cilin ai e sugjeronte në vend që të bëja intervistë referale. Njëra prej degëve të bibliotekës sonë e kishte një libër me po atë titull, porse ishte në huazim. Pastaj fillova procesin e intervistës, duke e pyetur përdoruesin nëse ishte i interesuar për libra elektronikë në atë temë. Po ashtu, i sugjerova që të kërkonte libra të përgjithshëm për Microsoft Excel (në këtë mënyrë duke e zgjeruar temën e tij origjinale) përmes shërbimit të huazimit ndërbibliotekar. Ky përdorues nuk do t'i kishte zbuluar këto burime shtesë po që se unë nuk do t'ia kisha sugjeruar ato. Është shumë e rëndësishme që të përshtatet procesi referal ndaj situatave të ndryshme dhe të jemi të përgatitur t'i bëjmë përdoruesit pyetje sqaruese kur na kërkojnë ndihmë. Udhëzimet e Shoqatës për Shërbime Referale dhe për Përdorues ofrojnë këshilla të mira se si të komunikojmë me përdoruesit për të siguruar që ata të gjejnë materialet më të dobishme dhe relevante për t'iu përgjigjur pyetjeve të tyre.

REFERENCA RUAN KOHËN E LEXUESIT

Nocioni i bibliotekarit referal është një pjesë e rëndësishme e procesit hulumtues. Ai nuk është nocion i ri e as nuk është i kufizuar vetëm në kontekstin e Shteteve të Bashkuara. Bibliotekari i Massachusetts - Samuel Swett Green, fliste për “Marrëdhëniet personale mes bibliotekarëve dhe lexuesve” në vitin 1876, duke sugjeruar që bibliotekarët “kontaktojnë lirshëm me ... përdoruesit, dhe u ndihmojnë atyre me çdo mënyrë”. Green ofron disa mënyra për të përmirësuar “marrëdhëniet ndërpersonale mes bibliotekarit dhe lexuesit” si entuziazmi (atë çfarë Shoqata e Shërbime Referale dhe për Përdorues e quan “interes”); ai këshillon që bibliotekarët “t'i japin pyetësit aq ndihmë sa ata kanë nevojë, por në të njëjtën kohë të provojnë t'i mësojnë të bëhen të pavarur në kërkimet e mëtuqjeshme”. Kjo është në pajtim me udhëzimin e katërt të Shoqatës për Shërbime Referale dhe për Përdorues, ku bibliotekarët fillojnë të bëjnë kërkimin dhe t'iu mësojnë përdoruesve se si t'i

shfrytëzojnë burimet e ndryshme.

S. R. Ranganathan, “babai” i bibliotekarisë në Indi, i përpiloi Pesë Ligjet e tij të Shkencave të Bibliotekarisë më 1931:

1. Librat janë për t'u përdorur.
2. Secili person - librin e tij apo të saj.
3. Secili libër - lexuesin e tij.
4. Ruan kohën e lexuesit.
5. Biblioteka është organizëm që zhvillohet.

Të gjitha ligjet e Ranganathan-it janë relevante me shërbimet referale, e sidomos Ligji i katërt është më i zbatueshmi në intervistën referale. E vërteta e Ligjit të tij është veçanërisht interesante po që se bëjmë zëvendësim të “burimeve bibliotekare” në vend të “librave” në formulimin e tij. Burimet bibliotekare janë për t'u përdorur; i blejmë, i katalogojmë, kështu që përdoruesit të mund t'i përdorin. Ekziston një burim për secilin përdorues, dhe secili përdorues e ka përdoruesin i cili ka nevojë për të. Shpesh procesi i gjetjes së materialit është aq kompleks sa që gjetja e burimeve për t'i përdorur – Ligji i dytë – është shumë e vështirë. Kjo është ajo ku bibliotekari referal e ka rëndësinë e vet: ne e zbatojmë për së afërmi Ligjin e katërt, duke i ruajtur kohë lexuesit. Përdoruesit shpesh vijnë te tavolina e referencës dhe thonë, “kam kërkuar gjithkund, por nuk arrita të gjej atë që më nevojitej!” Në përgjithësi, ata kanë kaluar një kohë mjaft të gjatë duke kërkuar “gjithkund”, dhe kur u tregojmë atyre burimet më relevante për hulumtimin e tyre, shpesh mund t'ua ruajmë kohën dhe t'i mësojmë që të jenë kërkues më efikas. Së fundi, Ranganathan është shprehur se biblioteka është një organizëm që zhvillohet dhe ndryshon; ai i ka shkruar këto ligje 76 vjet më parë, mirëpo ky Ligj është ende një e vërtetë me ardhjen e Internetit, koleksioneve digjitale, dhe postës elektronike. Roli i bibliotekarit referal është po aq i rëndësishëm si edhe më parë me përhapjen e burimeve digjitale; ne duhet t'i zhvillojmë shkathësitë tona intervistuese për t'ia ruajtur kohën lexuesit, si dhe t'i ofrojmë asaj apo atij burimet më të përshtatshme që u nevojiten.

Përktheu: Besim J. Kokollari

³ Cassell, Kay Ann and Hiremath, Uma, Reference and Information Services in the 21st Century : An Introduction. New York: Neal-Schuman Publishers, 2006, f. 15.

⁴ Green, Samuel Swett, “Personal Relations Between Librarians and Readers”. American Library Journal. 1.1 (1876): 74-81. Reprinted in Library Journal 118.11 (1993): fS4-5.

Pesë intervista referale: një vështrim hulumtues



BESIM J. KOKOLLARI

Pmes këtij hulumtimi hidhet dritë mbi nevojën e bibliotekarëve referalë, madje edhe në më shumë se një të tillë që të shërbejnë në tavolinën e referencës, duke u mbështetur në kërkesat e mëdha nga përdoruesit për informacion. Po ashtu, shihet se kryerja e detyrave nga bibliotekarët referalë varet shumë nga ambienti në të cilin punojnë; ku shumica e intervistave të suksesshme ndodhën atëherë kur tavolina e referencës kishte më pak studentë në radhë për të marrë informacion, duke rezultuar në më pak presion për kohën e bibliotekarëve referalë. Hulumtimi, po ashtu, thekson rëndësinë dhe domosdoshmërinë e të zhvilluarit të intervistës me përdoruesit.

HYRJE

Prania e shërbimit referalë është e domosdoshme në veprimtarinë e një biblioteke. Diku këto shërbime nuk janë të pranishme fizikisht, mund të janë shkrirë e kombinuar me shërbime të tjera të bibliotekës, mund të janë reformuar në shërbime referale përmes formave të tjera të komunikimit për t'i plotësuar nevojat e ndryshme të klientelës. E diku tjetër ky shërbim është

ende i pranishëm fizikisht, kryesisht, në një vend të dukshëm të bibliotekës, ku shërbimet referale realizohen përmes komunikimit të atypëratyshëm, nëpërmjet intervistave të shkurtra e të gjata, bisedave, telefonit, formave të tjera të komunikimit - përmes internetit, si adresë elektronike, mesazheve, tutorëve të ndryshëm, etj. Megjithatë, si aty ku shërbimet referale nuk duken dhe aty ku duken, ato në vete përfshijnë njohurinë, përvojën, gjeturinë, shpejtësinë, aftësinë dhe mënyrën e komunikimit, mënyrën e transferimit të njohurive te tjetri, oratorinë për të artikuluar, e një seri shkathtësish të tjera të bibliotekarëve referalë. Bibliotekarët referalë jo vetëm që dinë të ofrojnë përdoruesin me informacionin, përdoruesin me bibliotekën, përdoruesin me bibliotekarin, por edhe janë pasqyrë e kulturës së kultivuar të një biblioteke. Edhe gjatë shtjellit tonë të mëposhtëm të këtij punimi shihet domosdoshmëria e pranisë fizike të shërbimeve referale në një bibliotekë, e si rrjedhojë edhe e pranisë së bibliotekarëve referalë për t'u shërbyer sa më mirë përdoruesve.

Punimi është rezultat i një hulumtimi të bërë gjatë studimeve semestrale të autorit në shkollën e bibliotekarisë "Kolexhi Simons" në Boston të ShBA-ve. Hulumtimi, me metodën e vëzhgimit e të interpretimit, është realizuar në Bibliotekën W.E.B. Du Bois të Universitetit të Masaçusets në Amherst. Kjo Bibliotekë, po ashtu, ka qenë edhe vendi ku autori ka bërë punën praktike gjatë studimeve të tij për të realizuar një ndërthurje të njohurive praktike me ato teorike të fituara në Kolexhin Simons.

Biblioteka W.E.B. Du Bois ka mbi njëzet kate, një bibliotekë e lartë, me

kate të mbushura me koleksione, të reja e të vjetra, kryesisht të shkencave shoqërore, një bibliotekë aktive me shërbime, me personel e me studentë. Ajo është në qendër të kompleksit universitar e rrethuar me pemë e oborr të gjelbëruar, i përshkuar prej rrugicave të asfaltuara universitare. Një degë tjetër e Bibliotekës, e vendosur pak më larg, mban kryesisht koleksionin e shkencave natyrore. Së bashku, koleksioni i Bibliotekës me degë është mbi 5 milion njësi dhe me mijëra burime të abonuar elektronikë, të cilat e pasurojnë edhe më tej koleksionin e bibliotekës, dhe ofrojnë mundësi për shërbime më të shpejta. Biblioteka, së bashku me degët, u shërbejnë më shumë se njëzet mijë studentëve të Universitetit të Masaçusets në Amherst. Ajo, po ashtu, shikohet edhe si bibliotekë publike, e hapur për të gjithë. Biblioteka bënë pjesë në rrjetet e bibliotekave të vendit, si në katalogun përmbledhës ashtu edhe në huazimin e materialeve ndërmjet bibliotekave, që i japin bibliotekës si përgjegjësi ashtu edhe mundësinë e përcjelljes së zhvillimeve të reja dhe vjeljen e përvojave më të mira.

Edhe pse, si ndërtesë, biblioteka është e gjatë, ajo i ka shërbimet kryesore për përdorues në katin e parë dhe të dytë. Kati i parë ka shërbimet e përbashkëta të bibliotekës për përdorues, i cili mban afro njëqind kompjuterë për përdorues, tavolinën e referencës në vend të dukshëm, tavolinën për ndihmë teknike, shërbime për këshillime akademike, qendër për karrierë, qendrën e shkrimit, kabinete për studime private dhe grupe, etj. Këto shërbime e plotësojnë njëra-tjetrën, ku bibliotekarët dhe të tjerët në këto shërbime përipiqen t'u përgjigjen pyetjeve dhe nevojave të ndryshme të për-

doruesve të tyre. Megjithatë, ky hulimtim është përqendruar vetëm në shërbime që ofrohen në tavolinën e referencës. Kryesisht, është vëzhguar aktiviteti i një bibliotekare në punën e saj me pesë përdorues të ndryshëm të tavolina e referencës. Më poshtë po japim informacione se si kanë shkuar këto veprime, intervista e biseda veç e veç në kërkim të gjetjes së përgjigjeve më të përshtatshme për nevojat e përdoruesve, të plotësuara me mendime, komente e ide personale e të referuara në burime të tjera. Kjo bëhet për të lënë në dorë të lexuesit sa më shumë liri në interpretimin e situatave në të cilin gjenden bibliotekarët, dhe për të nxjerrë përfundime edhe më të zgjeruara në bazë të kontekstit në të cilin janë kryer këto veprime me shpresën se do të ndihmojnë në bërjen e vendimeve të drejta karshi shërbimeve në tavolinat e referencës në bibliotekat tona. Ky hulimtim kryesisht u drejtohet bibliotekarëve dhe drejtuesve të institucioneve bibliotekare dhe shpalos rëndësinë e të bërit intervistë referale me përdoruesit.

INTERVISTA E PARË

Pyetja e parë që u bë nga një student ishte e drejtpërdrejtë dhe ai e dinte se çfarë donte. Mirëpo rëndësia e kësaj interviste referale kishte të bënte me ambientin në të cilin ndodhi. Duke qëndruar në këmbë te tavolina e referencës, duke shikuar drejt dhe duke e përshëndetur studentin me 'si jeni?', dhe me pak studentë të tjerë duke prituri në atë kohë, bibliotekari referal e filloi këtë intervistë, apo më mirë të themi këtë bisedë referale. Biseda referale ndodhi kryesisht te tavolina e studentit, pasi bibliotekari shkoi t'i ndihmonte atje. Ai i ndihmoi t'i gjente artikujt që i dëshironin në internet, duke i përdorur disa veçori kufizuese të bazave elektronike. Bibliotekari referal e përcillte çdo veprim duke folur e shpjeguar ato përderisa rrinte prapa studentit, ndërsa vetë studentit e bënte kërkimin sipas udhëzimeve të bibliotekarit. Studenti e gjeti artikullin



*Biblioteka W.E.B Du Bois
e Universitetit të Masaçuests në Amherst*

për të cilin kishte nevojë dhe e falënderoi bibliotekarit, i cili nuk u largua nga tavolina e studentit përderisa artikulli u shtyp, dhe me të edhe biseda referale u përfundua.

Mënyra se si u zhvillua kjo bisedë është ai ambient "i qetë, pa shqetësime, i rehatshëm e pa tollovi", të cilin e përshkruan Riedling në artikullin e tij "Ide të mrekullueshme për përmirësimin e intervistave referale" dhe të cilat mundësojnë zakonisht një rrjedhë të qetë e të lehtë të intervistave referale. Sipas Riedling-ut, tavolina e referencës duhet të jetë afër koleksioneve si të shtypura ashtu edhe atyre në internet që të mund të shfrytëzohen nga bibliotekari referal dhe studentët, gjatë procesit të intervistës. Për më tepër edhe Bopp dhe Smith, autorë të librit "Shërbimet Referale dhe të Informacionit" (origj: Reference and information services: an introduction), këshillojnë që bibliotekari referal duhet ta hapë bisedën referale me studentin (përdoruesin) me një buzëqeshje, përshëndetje apo të shprehë interesim për palën që i drejtohet.

Nga kjo mund të thuhet që kjo intervistë u zhvillua në kushte të mira, pa ndonjë shqetësim, pasi nuk kishte përdorues të tjerë në pritje, e ndërsa bibliotekari e priti studentin me fjalë përshëndetëse, duke e hapur intervistën referale sipas këshillave dhe udhëzimeve të specialistëve të fushës së referencave.

Pasi që ishte një periudhë ku nuk kishte shumë studentë në pritje, bibliotekari gjente në kompjuterin e tij dhe në rafta libra referal të cilëve u hidhte një sy kritik, i përmblihte dhe krijonte një listë të këtyre titujve në kompjuterë për t'iu gjetur më vonë gjatë intervistave referale. Në këtë mënyrë ai zhvillonte edhe më tej njohurit e tij referale, përgatitej për hapin e ardhshëm të një interviste të suksesshme referale. Bopp dhe Smith (2001) në librin e cekur më lartë u këshillojnë bibliotekarëve referalë një strategji të tillë, e cila u ndihmon atyre në gjetjen dhe referimin e fenomeneve ontologjike e epistemologjike te përdoruesit.

INTERVISTA E DYTË

Edhe kjo intervistë i kishte disa prej karakteristikave të së parës, si pritja e mirë për studenten, dhënia e udhëzimeve në tavolinën e saj për të gjetur artikuj në një gazetë të njohur, etj. Megjithatë, strategjia e të dhënit të udhëzimeve ndryshonte nga e para. Në vend që ta lejonte studenten që ta kryente vetë kërkimin, kësaj here, bibliotekari e bënte vetë kërkimin dhe në të njëjtën kohë ia shpjegonte hapat studentes. Ndryshimi i strategjisë së dhënies së udhëzimeve vinte thjesht nga arsyeja se në tavolinën e referencës sapo kishin filluar ta frekuentonin më shumë përdorues dhe se bibliotekari ndoshta nuk dëshironte të shpenzonte shumë kohë në një pyetje të tillë. Si do që të jetë, studentja u falënderua pasi ajo kishte marrë atë që donte. Megjithatë, në planin afatgjatë, studentja do të kthehej përsëri te tavolina e referencës për të kërkuar mbase edhe përgjigje për pyetje të natyrës së njëjtë.

Kisha përshtypjen se studentja nuk kishte mësuar shumë për bazën në të cilën bibliotekari ia gjeti artikullin e po ashtu edhe për mënyrën se si u gjet ai nga arsyeja se intervista shkoi shumë shpejt dhe se studentja nuk e kishte bërë kërkimin me dorën e vet, e cila do t'i jepte më shumë përgjegjësi, më shumë ndjeshmëri dhe më shumë vetëbesim në kërkimin e bërë dhe ato të ardhshme.

INTERVISTA E TRETË

Kjo intervistë ndryshon krejtësisht nga dy të parat. Një student 'i vështirë', i cili iu afrova tavolinës së referencës, nuk i ofroi informacione të mjaftueshme bibliotekarit referal për problemin e tij. Kur bibliotekari referal kërkonte prej tij më shumë informacione, si vëllimi apo numri i gazetës të cilin e donte, studentin rrudhi krahët, duke i lënë të ditur bibliotekarit se nuk kishte ndonjë informacion për atë gjë. Bibliotekari nuk kishte zgjidhje tjetër veç se ta dërgonte studentin te Sektori i periodikut me informacionin që e kishte dhe të shpresonte ta gjente numrin e gazetës. Studenti reagoi, duke thënë që ai nuk ishte numri të cilin e kërkonte. Bibliotekari e ftoi studentin që të kthehet sërish te tavolina e referencës dhe të bëjnë një kërkim në katalogun elektronik. Me t'u kthyer në tavolinën e referencës, studentin shikoi në çantën e tij dhe nxori një letër, në të cilën e kishte shkruar titullin dhe numrin e gazetës, të cilin e kërkonte. Ai ia dha atë bibliotekarit. Bibliotekari e hapi katalogun elektronik, e ktheu ekranin e kompjuterit kah përdoruesi që të mundë ta përcillte, dhe filloi kërkimin duke ia shpjeguar të gjithë hapat studentit deri te gjetja e rezultateve. Doli që studentin duhej të shkonte te një degë tjetër e bibliotekës pasi numri i gazetës që ai kërkonte nuk gjendej atje.

Shihet qartë se detyra, para së cilës ishte bibliotekari, ishte e thjeshtë - të kryejë një kërkim në katalogun elektronik dhe studentit t'i jepej përgjigjja e duhur. Por, kjo nuk kishte të bënte



Shërbimet referale në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës

shumë me llojin e pyetjes, por me vetë natyrën e studentit. Pse ai nuk e kishte treguar që në fillim letrën në të cilën e kishte shkruar titullin dhe numrin e gazetës, që do ta radhiste pyetjen në kategorinë e pyetjeve të drejtpërdrejta? Cilat arsye kishin qenë që ai të mbante të fshehur këtë informacion, përderisa gazeta të cilën kërkonte nuk paraqiste ndonjë intimitet, etj.? Këto janë pyetje që vështirë mund t'i gjendet përgjigjja, e mbase studentin është i vetmi që e di përgjigjen. Si do që të jetë, kjo na bëri që ta quanim atë student 'të vështirë'.

Në këtë pikë, po ashtu, do të bënim pyetjen nëse strategjia e bibliotekarit referal që të shkoj drejt e te raftet ishte gjë e drejtë. Sipas Bopp dhe Smith (2001) kur bibliotekarët referalë nuk kanë informacione të bollshme nga përdoruesit, ata duhet të gjejnë se çfarë donë përdoruesit gjatë procesit referal

(f. 57). Dhe, meqë studentin nuk donte në fillim të jepte informacione të mjaftueshme, strategjia që të shkoj te raftet ishte e mirë, pasi a mbajti gjallë intervistën referale, dhe në fund rezultoi e suksesshme.

INTERVISTA E KATËRT

Intervista e katërt u zhvillua në një hapësirë private, të mbyllur, afër tavolinës referale, e caktuar për pyetje të ndjeshme dhe të cilat kërkojnë më shumë kohë. Si gjithnjë, bibliotekari referal e priti studentin me një sjellje mirëseardhje, të përcjellë menjëherë me "si mund t'ju ndihmojmë?". Studentin i kishte dy pyetje të ndryshme. Njëra kishte të bënte me materialet e fushës së antropologjisë, dhe tjetra me të kup-tuarit e bazave elektronike, të cilat do t'i ndihmonin atij që të gjente artikuj

relevantë për tezën e tij të punimit. Këto, në realitet, nuk ishin pyetje apo artikulime të drejtpërdrejta të studentit, por ishin rezultat i asaj që bibliotekari referal arriti të nxirrte nga intervista që e zhvillonte me të. E, ndoshta kjo ishte edhe një prej arsyeve që bibliotekari referal zgjodhi ta zhvillonte intervistën me të në këtë hapësirë private, ndërsa një arsye tjetër e zgjedhjes së këtij vendi ishte po ashtu se nuk kishte studentë të tjerë në pritje të tavolina e referencës. Studenti bënte kërkimin, duke ndjekur udhëzimet e bibliotekarit në kompjuterë dhe herë pas here i përgjigjej pyetjeve të tij. Bibliotekari tregonte vazhdimisht interes në programin e studentit, duke u interesuar “a mund të më tregoni edhe më shumë për temën tuaj”. Pas pak kohe, bibliotekari kuptoi se tema e tij kishte të bënte po ashtu me fushën e psikologjisë. Kjo intervistë u zhvillua në formë dialogu, ku studentit bënte kërkimin, por nganjëherë edhe bibliotekari bënte kërkim. Bëheshin pyetje, nxirreshin përgjigje, jepeshin udhëzime për mënyra të ndryshme të gjetjes së materialeve, etj.

Meqë studentit ishte i interesuar kryesisht për gjetje të materialeve, ai i tregoi bibliotekarit se më herët kishte gjetur artikuj përmes faqes së Bibliotekës, por tash kishte harruar se si i kishte gjetur. Bibliotekari referat, pas një interviste të shkurtër me të, kuptoi se ai kishte pak njohuri për bazat elektronike; ia shpjegoi disa informacione të fushës së tij dhe e udhëzonte se si të gjente materialet në to. Studenti shprehu entuziazëm dhe shpjegoi se asnjëherë më parë nuk kishte ditur që ekzistonin këto mundësi. Bibliotekari, pas pak kohe, filloi ta mbyllte procesin e intervistës referate, duke i kërkuar studentit që të caktonin një takim tjetër. Në ndërkohë, atij iu desh të shkante te tavolina e referencës që të kontrollonte orarin e takimeve; me t'u kthyer pa që studentit po kërkonte në bazën e të dhënave, dhe nuk e ndërpreu për një kohë.

Po ta shohim nga afër këtë, kjo është një situatë ku secili fiton – edhe

bibliotekari edhe përdoruesi janë të kënaqur me rezultatet e intervistës. Dhe se rruga deri te sukcesi u ndërtua përmes: interesimit që ai tregoi për temën e studentit, dhe ndikimit të ambientit të qetë në të cilin u zhvillua intervista (Gers and Seward, 2002). Kjo situatë po ashtu tregon për ndikimin që ka koha e mjaftueshme në dispozicion të një bibliotekari gjatë intervistave, e cila rrit dukshëm nivelin e përqendrimit dhe efikasitetit të bibliotekarit referal.

INTERVISTA E PESTË

Kjo intervistë u zhvillua në ritmin e zakonshëm; bibliotekari referal ngriti kokën për ta përshëndetur studentin në radhë me një “tungjatjeta!”. Studentja e parashtroi pyetjen, ndërsa bibliotekari ktheu ekranin e kompjuterit kah studentja dhe filloi kërkimin në katalogun elektronik të bibliotekës, duke shpjeguar hapat që i bënte gjatë procesit. Meqë titulli i revistës, të cilin e kërkonte studentja, doli të ishte vetëm në formë të shtypur, atëherë bibliotekari mori numrin e raftit të atij titulli, i shpjegoi studentes se si do të mund t'i gjejë materialet në bazë të këtij numri në të ardhmen, dhe të dy së bashku u nisën për te rafti, i cili mbante këtë titull, gjithnjë duke i treguar për mënyrën e renditjes së materialeve në bibliotekë. Materiali i gjetur i kënaqi nevojat e studentes dhe kështu bibliotekari u nis për në tavolinën referale. Gjatë kthimit, aty diku afër fundit të rreshtave të rafteve të gjata, ai ktheu kokën dhe i tha studentit “nëse ke ndonjë pyetje tjetër, mos harro të më njoftosh?!”. Pyeta veten për pak kohë - për qëllimin e kësaj. Studentja nuk e kishte dëgjuar, pasi ishte mjaft larg tij. A thua ishte prania ime që e bëri bibliotekarin referal të vepronte në atë mënyrë? Apo ishte tavolina e stërngarkuar e referencës, e cila ia kishte tërhequr vëmendjen? Pa marrë parasysh se cila ishte arsyeja, biseda referale u krye me sukses, pasi fytyra e studentit shprehte kënaqësi me tit-

ullin e revistës në duar, dhe çfarë ndodhi më pas nuk kishte ndonjë ndikim të madh.

PËRFUNDIM

Nga këto që u thanë më lartë, mund të vihet në përfundim se nevojitet më shumë se një bibliotekar për të kryer shërbime referale në mënyrë të suksesshme, nëse ka shumë përdorues të cilët i drejtohen tavolinës së referencës. Në rastet kur ka bibliotekarë të pamjaftueshëm që shërbejnë në tavolinën e referencës, atëherë intervistat referale mund të jenë më të shkurtra, mund të ketë kohë të mjaftueshme në dispozicion për përdorues, dhe si rrjedhojë më pak njohuri të nxënë nga përdoruesit. Bisedat mes bibliotekarit referal dhe studentëve treguan se zhvillimi i intervistës referale paraqet mjetin kryesor me të cilin u jepet përgjigje e duhur pyetjeve të përdoruesve. Si e tillë, paraqet edhe nevojën e të zhvilluarit të një interviste referale. Bibliotekarët kryesisht përdorën burime elektronike dhe katalogun elektronik të bibliotekës për t'u përgjigjur pyetjeve të ndryshme. Nga këtu u pa, po ashtu, që ambienti në të cilin zhvillohet një intervistë luan rol të rëndësishëm në efikasitetin e bibliotekarit, që me bashkëdyzimin e njohurive të bibliotekarit për burimet referale dhe gjeturinë dhe sjelljet e tij, shpijnë drejt suksesit të një interviste referale.

REFERENCAT

- Bopp, R. E., & Smith, L. C. (2001). Reference and information services: an introduction, Englewood, Colorado: Libraries Unlimited.*
- Gers, R., & Seward, L. J. (1985, November 1). Improving reference performance: results of a statewide study. Library Journal. p. 32-35.*
- Riedling, A. M. (2000, Nov/Dec). Great ideas for improving reference interviews. Book Report. 19, (3), p. 28.*

Libri shqip në Kosovë

(1944 - 1984)



MR. TAHIR FONIQI

Ky hulumtim bibliografik përfshin botimet monografike shqipe të botuara në ish-Jugosllavi gjatë periudhës kohore 1944 - 1984: botime, ribotime e përkthime e forma të tjera botimi; e kemi nisur me botimet e vitit 1944, ndonëse edhe më 1943 janë botuar disa broshura të formës artikull, rëndom të shaptilografuara.

BOTIMET BIBLIOGRAFIKE

Me tekstet e para bibliografike shqipe në Kosovë takohemi më 1946, kuptohet të formës artikuj. Gjatë periudhës 1946 - 1984 kemi regjistruar rreth 200 tekste të këtu nga të cilat, për ilustrim i kemi veçuar tekstin e Ali Rexhës: "Bibliografi publikimesh në gjuhën shqipe në Kosovë e Metohi 1944 - 1958", botuar në revistën shkencore të Prishtinës "Përparimi", gjatë viteve 1959 - 1961, në trembëdhjetë vazhdimë. Ky tekst ka [702] njësi bibliografike dhe është hartuar mbi bazën në autor, përkatësisht kronologjike, pa u përfillur renditja alfabetike e njësisë bibliografike. Për kah lloji i përket bibliografisë së përgjithshme.

Hartues të teksteve të para bibliografike shqipe në Kosovë merren Kadri Halimi, Nahire Kabashi, Mehmet Gjevari, Sulejman Drini, Adem Demaçi, Ali Rexha, Sevdie Ahmeti, Veli Veliu etj.

Fillimisht janë hartuar bibliografi

elementare, primare, kronologjike e retrospektive, me lëndë nga letërsia, gjuhësia, historia, folklori dhe etnologjia, të hartuara, rëndom, nga punonjësit amatorë.

Më 1957 fillon botimi edhe i bibliografive të formës libër. Gjatë periudhës 1957 - 1984, janë botuar rreth 20 tekste bibliografike të kësaj forme: "Katalog 1957", Prishtinë, 1957, përpiluar nga M. Gjevari, S. Drini e A. Demaçi, "Një pasqyrë e veprimtarisë botuese në Kosovë", Prishtinë, 1973, përpiluar nga Mehmed Gërguri, Sevdije Ahmeti e Musa Gërguri, "30 [tridhjetë] vjet të veprimtarisë botuese në Kosovë", Prishtinë, 1975, Isak Shema, Ibrahim Rugova, "Bibliografia e kritikës letrare shqiptare 1944 - 1974", Prishtinë, 1976, Sevdie Ahmeti, Amedan Jani, Musa Gërguri, "Jeta e re" "Bibliografia 1949 - 1974", Prishtinë, 1976, Ali Rexha, "Bibliografia e Entit të Teksteve dhe të Mjeteve Mësimore të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës 1962 - 1977", Prishtinë, 1977, "Dyzet vjet veprimtari botuese 1943 - 1983 : Katalog", Prishtinë, 1983, Zymber Hasan Baku (Kruja), "Bibliografi e zgjeruar e veprave të Sami Frashërit", Prishtinë, 1984 etj.

Këto tekste reflektojnë kontinuitetin botues të kësaj literature gjatë periudhës 1957-1984 dhe i përkasin bibliografive elementare, primare, kronologjike e anotuese, speciale, selektive me bazë në autor.

FILLIMI - NË FRYMËN E TRADITËS

Fillimi i botimit të librit shqip në Kosovë është bërë në frymën e lëvrimin të letrave shqipe, që nga Gjon Buzuku (shekulli XVI), Lukë Bogdani (për jetën e tij - dihet vetëm se ka qenë kushëri i Pjetër Bogdanit, të cilit ia ka kushtuar një poezi), Pjetër Bogdani (rreth 1625? - 1689), Gjon Nikollë Kazazi (1702 - 1752) etj., përfshirë këtu edhe ndikimin e letërsisë gojore. Ky i fundit ka krijuar në të folmen e

Gjakovës, që paraqet interes për njohtjen e të folmeve shqipe të truallit gjuhësor të Kosovës. Ekzistojnë edhe dokumente, që flasin se gjuha shqipe është përdorur edhe në komunikimin e letërkëmbimin e tregtarëve të Prizrenit e të Gjakovës gjatë shekullit XIX.

"Letërsia shqipe në Kosovë, e vjetër dhe e re, është pjesë e zhvillimit të kulturës e të letërsisë së shqiptarëve nga shekujt më të hershëm deri në ditët tona".

Më 1835, ndërkaq, na vjen libri letrar Vehbije (dihuratë, dhunti), në gjuhën shqipe, autografi, shkruar më 1835, në alfabetin arabo-turk, nga myderrizi Tahir Efendi Boshnjaku nga Gjakova e kthyer në alfabetin shqip nga Ismail Haxhi Tahir Gjakova, botim i Sofjes më 1907.

Gjithnjë sipas Profesor Idriz Ajetit, Vehbije është "Dokumenti më i vjetër i shqipes së Kosovës i shkruar me alfabetin arabo-turk".

Ndonëse "kjo vepër ka rëndësi fetare, ajo sot merr edhe rëndësi të madhe gjuhësore e kulturore, sepse, si vepër e parë e ruajtur në gjuhën shqipe në Kosovë, na dëfton se çfarë gjuhe është përdorur në këtë rreth gjeografik të shqiptarëve në fillim të shekullit 19-të". Libri ka edhe vlera letrare, ngase ai "u shkrua në vargje e prozë...".

Kaptinë në vete këtu paraqesin shkrimet letrare të autorëve të shekullit XIX-XX: Ndue Bytyçi (1847 - 1917), Hilmi Maliqi (1865 - 1928), Haxhi Ymer Lutfi Paçarizi (1869 - 1929), Shtjefën Gjeçovi (1874 - 1929), Shaip Zurnaxhiu (1884 - 1951), Lazër Lumezi (1870 - 1941) etj.

Ndue Bytyçi është poeti i parë, që, në gjuhën shqipe, e lëvroi tingëllimën (sonetin). Ndërsa Shtjefën Gjeçovi shquhet sidomos me veprën "Kanuni i Lekë Dukagjinit". Hilmi Maliqi, nga Rahoveci, ka lënë disa shkrime shqipe, madje edhe një "Divan" me 77 këngë mistike me shkronja arabe. Ndërsa, Lazër Lumezi nga Prizreni, krahas veprimtarisë së gjerë arsimore e kulturore, "Shkruante tekste shkollore, përk-

thente dhe adaptonte pjesë teatrale dhe i vende ato në skenë me nxënësit e vet dhe rininë e Prizrenit". I njëjti shkruante edhe tregime, vjersha për fëmijë, pjesë teatrale etj. Ai ka shkruar komedinë një aktësh "Makaromat e shejtanit" e cila është shfaqur, për herë të parë, më 1935 në Prizren. Ky tekst teatror ka ndërtim të rrjedhshëm letrar dhe damkos koprracinë.

Burimet e tjera na çojnë te viti 1928, te botimi i një drame me tre akte "Irredenti" me autor Jusuf Puka nga rrethi i Gjakovës. Ne nuk kemi gjetur të dhëna të tjera për këtë tekst, pos këtij informacioni. Mbase këtu është fjala për ndonjë tekst të hartuar për nevojat e trupave teatrale amatore të kohës. Ndërmjet dy luftërave botërore, në Pejë e Gjakovë, kanë zhvilluar aktivitete kulturore dy shoqëri kulturore: "Dukagjini" e "Agimi", ku luheshin edhe pjesë teatrale.

Këtu duhet përmendur edhe fletushkën e parë shqipe, në Jugosllavinë e vjetër, "Hylli" e cila botonte edhe vjersha, tregime, krijime gojore etj. Ajo ka dalë në Prizren, me iniciativën e në përkujdesjen e Mark Krasniqit, gjatë vitit shkollor 1939/1940 - mars 1941. Kanë dalë 15 numra të shaptilografuar të këtij publikimi.

Rol të rëndësishëm ka pasur edhe letërsia gojore; kënga epike-heroike "Bajram Curri i hipi atit", hartuar nga Asim Vokshi.

PREJ LITERATURËS POLITIKO-SHOQËRORE DERI TE ENCIKLOPEDIA

Vepri i botuar në librit shqip në Kosovë, përkatësisht në ish-Jugosllavi, pas Luftës së Dytë Botërore, fillon në nëntor 1944 me artikullin "Partija komuniste dhe kush janë të gjithë aleatët e okupatorit" e Josip Broz Titos. Në të vërtetë ky është titull i për-bashkët edhe i dy artikujve të tjerë: "Nën hijen e okupatorit" të Velko Vllahoviqit dhe "Këshilli antifashist i çlirimit kombtar të Jugosllavis dhe Partija komuniste" të Mosha Pijades. Kjo broshurë ka dalë në Prizren, në 40 faqe shaptilografimi e në 500 kopje në format 20 x 14 cm. Gjatë këtij viti kanë dalë edhe tre tituj të tjerë, të gjithë të përkthyer nga gjuha serbokroate.

Viti 1945 nis me botimin e teksteve

shkollore: "Këndimi im i parë", shtypur në Tiranë në 20000 kopje, "Metodë për mësimin e gjuhës shqipe fëmijve 5-7 vjeçar", hartuar nga Ibrahim Riza, shtypur në Prizren në 500 kopje e vazhdon me botimin e literaturës politiko-shoqërore. Gjatë këtij viti botohen 20 njësi bibliografike, më 1946 - 16 etj.

Karakteristikë e botimeve të dhjetëvjetëshit të parë botues 1944 - 1954 është botimi i teksteve shkollore me autorë shqiptarë, fillimi i botimit të letërsisë origjinale shqipe, i gjuhësisë shqipe, botimi i titujve të parë nga letërsia e popujve të RSFJ-së, botimi i letërsisë botërore, krijimtarisë gojore etj. Kështu, botohen: "Abetare për të rritur", hartuar nga Mehmet Gjevari, Salih Kolgeci, Ibrahim Riza e Rexhep Shpendi, "Abetare për klasën e parë të shkollave fillore", punuar prej Mehmet Gjevorit, Stathi Kostarit e Jani Gjinos, "Libër leximi për klasën e V dhe të VI të shkollave tetëvjeçare dhe për klasën e I dhe të II të gjimnazeve", hartuar nga Petro Janura e Krum Toshev, "Nga letërsia shqipe, Libër për fëmij" i Vlladimir Nazorit, "Kangë popullore shqiptare të Kosovë...", mbarështuar prej Vojislav S. Dançetoviqit e Anton Çettës, "Diftoret e shqipes dhe historiat e tyre" të Selman Rizës, "Kasollja e Xha Tomit" e Harriet Beshher Stou, "Liza në botën e çudinave" nga Luis Karol, përkthyer nga anglishtja nga Beqir Çela e Hysen Çela, "Robinson (Crusoe)" nga Daniel Defoe, "Jul



Qesari" nga Viliam Shekspiri në përkthim të Fan S. Nolit etj.

Periodha 1955 - 1984, ndërkaq, karakterizohet me botimin intensiv të titujve të librave originalë shqip, duke filluar nga tekstet shkollore e universitare deri te enciklopedia shqipe, botimi i të gjitha zhanreve letrare të letërsisë shqiptare: tregimeve, romanëve, dramave, kritikës letrare e teatrore e deri te kompletet letrare, si kompleti "Vepra" i Sterio Spasse, tetë libra, ai i Fan S. Nolit, shtatë libra dhe kompleti i Viliam Shekspirit në dhjetë libra etj. Kur jemi te botimi i librit të parë i EJ në gjuhën shqipe (është promovuar në Prishtinë më 20 nëntor 1984); vlen të thuhet edhe kjo: ky vëllim përmban 1402 njësi e 78 udhëzime. Nga Redaksia për Kosovën, për këtë vëllim, janë shkruar 35 njësi me 12 punime ilustrative. Tirazhi i botimit të EJ, në gjuhën shqipe, është 5000 kopje.

Në mbarim të vitit 1984 numri i titujve të botuar arrin në 6568: 3200 të Redaksisë së botimeve Rilindja, 3084 botime të Entit të Teksteve dhe të Mjeteve Mësimore të Kosovës e 284 botues të tjerë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Bashkësia Krahinore e Punës Shkencore, Enti i Historisë, Biblioteka Popullore dhe Universitare e Kosovës, revistat: "Jeta e Re", "Pionieri", "Zëri i Rinisë", "Bota e Re", "Flaka e Vëllazërimit" e Shkupit etj. Vetëm botimet e Rilindjes janë botuar në 13311614 kopje.

/ vijon në numrin e ardhshëm /

Tematika dhe konteksti sociokulturor i botimeve në Kosovë

SHQIPE ASLLANI

SHKËNDIJE BERISHA

HYRJE

Në rrethanat e një realiteti kulturor e politik në formim, karshi dijeve, kulturës e arsimit, në Kosovë vijon me një dinamikë në rritje edhe kultura e botimit, në kuptimin sasior e cilësor. Pra, në këtë kontekst, kur trendet e kulturës e të arsimit i përcaktojnë edhe botimet - formatet dhe llojet e botimeve, në njërën anë, dhe tematika e tyre, në anën tjetër, do të ishte e rëndësishme që, nëpërmjet një analize të të dhënave, që tashmë janë bërë, nga Shërbimi i CIP-it (Katalogimi në botim), të japim një vështrim se çfarë botohet, përkatësisht cilat fusha e dominojnë tregun e botimeve në Kosovë.

Meqë puna dhe aktiviteti ynë është i lidhur me CIP-in, një shërbim përpunimi të njëjësive libër në botim, arrijmë të marrim, në të njëjtën kohë, informacionin dhe të përcjellim gjithë veprimtarinë botuese në Kosovë - të njëjësive libër. Përcjellja specifike e veprimtarisë botuese në Kosovë, nëpërmjet përcaktuesve të fushave në të cilat botohet: tematik, gjuhësor, akademik etj, jep një pamje të qartë për botimet dhe profilin e botuesve, të cilët diktohen dhe diktojnë aspekte të zhvillimit arsimor dhe kulturor të Kosovës gjatë këtyre viteve të pasluftës.

BOTIMET NË KOSOVË SIPAS KUD-it

Në këtë analizë të botimeve gjatë vitit 2007 në Kosovë, sipas KUD-it, (ndarjes lëndore), informacioni i organizuar sipas statistikave, jepen sasitë në numër dhe përqindje të botimeve në secilën fushë. Krahas kësaj, kemi përcaktuar edhe të dhëna që krahasohen, të botimeve në nivele e kritere të ndryshme, që kemi konsideruar të jenë të vlefshme për opinionin kulturor në Kosovë, duke i marrë si statistika - vërtetësia e të cilave mundëson një interpretim.

Nga fundi i shkurtit 2007 deri në fund të dhjetorit 2007, janë botuar 600 tituj. Pra, kjo shifër e dhënë për numrin e botimeve për rreth një vit, është për botimet që kanë marrë dhe CIP-in dhe numrin e ISBN-së në BKUK gjatë vitit 2007. Pra, të sqarohemi: jo çdo botues merr CIP-in për botimin

që vë në treg në Kosovë. Ende një numër i botimeve dalin pa CIP dhe ISBN, edhe pse përgjegjësia e botuesve në Kosovë, për t'i pajisur botimet e tyre me këta identifikues është rritur.

Para se të japim më poshtë të dhënat për botimet nëpër fusha - klasifikuar sipas tabelës së KUD-it (Klasifikimit Universal Decimal), duhet thënë se jo pak tituj, që botohen, pra që marrin CIP-in në BKUK, kanë përmbajtje të përzier dhe marrin dy e më tepër indekse; përmbajtja e librave përcaktohet përmes indekseve të fushave e të dijeve të ndryshme.

Në vijim po japim numrin e titujve të botuar në Kosovë (pra që kanë marrë CIP) gjatë vitit 2007, sipas KUD-it: Çështje të përgjithshme. Shkenca dhe dituria. Organizimi. Informacioni, janë klasifikuar (botuar) - 21 tituj; Filozofia. Psikologjia - 18 tituj; Feja. Teologjia - 32 tituj; Shkencat shoqërore - 116 tituj; Matematika dhe shkencat e natyrës - 59 tituj; Shkencat e aplikuarat. Mjekësia. Teknologjia - 23 tituj; Artet. Muzika. Sporti - 40 tituj; Gjuhësia. Letërsia - 234 tituj; Gjeografia. Biografia. Historia - 57 tituj.

Mbështetur në të dhënat e mësipërme, mund të konstatohet se gjatë vitit 2007, janë botuar tituj që u përkasin të gjitha fushave të dijes - ndarjes sipas Klasifikimit Universal Decimal - 0/9. Dominojnë botimet nga Gjuhësia dhe Letërsia - 234 tituj, ose 39%, e botimeve të përgjithshme; nga Shkencat shoqërore - 116 tituj ose 19.3 %; nga Shkencat natyrore - 59 tituj ose 9.8% etj..

Më së paku është botuar nga Filozofia - 18 tituj ose 3%.

Shkencat e natyrës/Shkencat shoqërore. Nëse krahasojmë numrin mes botimeve në Shkencat e natyrës dhe Shkencat shoqërore, del se në Shkencat shoqërore, shkencat e përgjithshme, filozofia, feja, historia, janë botuar 244 tituj ose 40.6%, kurse në Shkencat e natyrës dhe ato të Aplikuarat - janë botuar 82 tituj ose 13.6%

Gjuhësia dhe Letërsia. Dallimi është i theksuar, po ashtu, mes Gjuhës, në njërën anë, dhe Letërsisë, në anën tjetër. Nga gjuhësia janë botuar 36 tituj ose 6 %, ndërsa nga Letërsia - 198 tituj ose 33%. Nga letërsia e huaj (e përkthyer në gjuhën shqipe) janë botuar 24 tituj ose 4%; nga Letërsia për fëmijë - janë botuar 31 tituj

ose 5.1%.

Ndërsa, nëse i shtohet kësaj analize statistikore - numri i botimeve nga fusha e Letërsisë, sipas gjinive, del se: poezi - janë botuar rreth 13.1% e titujve nga Letërsia, dramë - 0.05%, prozë - 5.5 %, ese - 0.8 %; gjini të tjera: kritikë letrare, kujtime, biografi, antologji, publicistikë - 4.5%.

Botimet shkollore/Botimet universitare. Dallimi mes numrit të Botimeve shkollore dhe Botimeve universitare, është, po ashtu i theksuar. Tekstet universitare dhe shkollore gjithsej janë 199 tituj ose 33.1%, prej tyre Tekste shkollore janë - 188 tituj ose 31.3%, ndërsa Tekste universitare janë 10 tituj ose 1.6 %.

Libra të përkthyer. Prej të gjitha botimeve të vitit 2007, tituj të përkthyer janë rreth 10%.

PROFILI I BOTUESVE

Botuesit - numri i titujve dhe profili. Në Kosovë, Shtëpitë botuese, karshi Institucioneve botues dhe Autorëve botues, dominojnë në kuptimin sasior tërësinë e botimeve. Gjithnjë duke iu referuar të dhënave për botimet në Kosovë që marrin CIP-in, gjatë vitit 2007, me 15.8% të të gjitha botimeve është "Libri Shkollor", shumica dërmuese e botimeve të kësaj shtëpie botuese janë tekste shkollore, më pas vjen "Dukagjini" me 7.6 % të botime; kjo shtëpi përfshin botime me karakter dhe moshash të ndryshme. Pastaj vijnë botuesit që janë të profilizuar kryesisht në fushat dhe zhanret e arteve, përgjithësisht të letërsisë. Nder botuesit e këtij profili që i dominojnë botimet në Kosovë janë Shtëpia botuese "Faik Konica" me 4.5% botime, Shtëpia botuese "Rozafa" me 3.1% etj. Prej Institucioneve botues, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës merr pjesë në numrin e përgjithshëm me 1.6 % të botimeve, Universiteti i Prishtinës me 10 tituj ose 1.6 %, Instituti Albanologjik i Prishtinës - me 1.3 % etj; ndërsa, universitet private kanë botuar 10 tituj ose 1.6% të të gjithë tekste universitare.

Prej të gjitha kategorive të botuesve, të cilët kanë botuar gjatë vitit 2007, Shtëpitë botuese private prijnë me 506 tituj të botuar, ose 84.3% të të gjitha botimeve, Institucionet si botues janë gjithsej 9 me 8.5% ose 51 tituj, botues individual janë 7.1% ose 43 tituj të botuar.

Kujdesi gjatë përdorimit të materialeve bibliotekare

(Vështrim i përgjithshëm)



BEDRIJE MEKOLLI

Dëmtimi i librave, gazetave, dokumenteve të ndryshme, hartave, fotografive etj., është dukuri mjaft e shpeshtë. Përdorimi i përhershëm dhe jo i mirë, shumë shpejt mund ta shndërron librin e ri në të vjetruar dhe të papërdorshëm, që më pas kërkon riparim të shtrenjtë, lidhje sërishmi, apo zëvendësim.

Disa masa të thjeshta preventive, që lidhen me përdorimin e duhur të materialeve bibliotekare, dukshëm mund të mënjanojnë dëmtimin e tyre.

Shumica e librave nuk janë kopje muzeale, që ruhen të arkivuara si pjesë e trashëgimisë nacionale apo njerëzore, por thjesht, janë të shërbim të përdoruesve. Nga kjo mënyrë e përdorimit, ekzistojnë mundësitë për dëmtime të papritura. Një përkujdesje ndaj materialeve bibliotekare, nga stafi i bibliotekës, do të ndihmojë ruajtjen e tyre, por edhe do t'i inkurajojë përdoruesit që t'i përdorin ato me kujdes.

Meqenëse një pjesë e konsiderueshme e materialeve përbëhen nga letra e cila është e thyeshme dhe e ndjeshme, duhet siguruar që përdoruesit mos t'i dëmtojnë materialet, duke rritur përgjegjësinë e stafit, i cili i ndihmon lexuesit në përdorimin e

materialeve të ndjeshme.

Prishjet apo dëmtimet që shkaktohen më së shpeshti te librat apo materialet e tjera ndodhin si pasojë e pakujdesisë, por edhe e mosnjohjes së disa rregullave për përdorim të materialeve bibliotekare.

Dëmtimet janë të mundshme gjatë sistemimit apo radhitjes së librave në rafte, gjatë tërheqjes, bartjes së librave, përdorimit të gjërave të ndryshme gjatë leximit, përfshirë: lapsa, ngjyra, mbajtëse të ndryshme, pastaj gjatë procesit të fotokopjimit, mirëmbajtjes, përdorimit të ushqimit në ambiente ku përdoret libri, etj.

DUART E PASTRA



Megjithëse një pjesë e madhe e vjetërsirave, grisjeve dhe shqyerjeve janë të paevitueshme gjatë përdorimit, këto dëmtime mund të reduktohen në ambiente bibliotekare, ku ruajtja dhe konservimi janë prioritete. Bibliotekat duhet të aplikojnë programe të ndryshme edukative me qëllim të nxitjes së stafit dhe përdoruesve që t'i mbajnë duart e tyre pastër gjatë përdorimit të librit (materialit bibliotekar).

Përdorimi i materialeve bibliotekare me duar të pastra ndihmon që të mbahen ato në gjendje të mirë, prandaj, është e domosdoshme që gjithmonë të siguroheni që duart tuaja

të jenë të lara dhe të pastra. Duart e palara, të ndotura, të lagura dhe të yndyrshme, lënë shenja të pashlyeshme në materialet bibliotekare.

Duhet pasur kujdes që gishtërinjtë mos të lënë gjurmë të ndotjes në mbështjellësit dhe në bllokun e tekstit, (për shembull, ka raste kur fletët shfletohen me gishtërinj të lagur). Shumica e njollave në mbështjellësit dhe fletët e librit është nga zhylli apo papastërtitë e grumbulluara të gjurmëve të gishtit.

Kur stafi dhe përdoruesit konsultojnë tekstet e rralla ose unikate, ata duhet të përdorin dorëza pambuku, të cilat parandalojnë transferimin e yndyrës natyrale të gishtërinjve në fletët e ndjeshme. Përdoruesit duhet gjithashtu të përdorin dorëza pambuku për përdorim të materialeve jolibër, siç janë mikrofilmat, fotografitë, gravurat, negativet, duke prekur vetëm sipërfaqet larg imazheve.

Kujdes i veçantë duhet pasur në përdorimin e materialeve me dimensione të mëdha, si: harta, posterë, flamuj letre, etj. Gjatë manipulimit me ndonjë material të tillë bibliotekar, duhet siguruar hapësirë të bollshme të rehatshme, të pastër, në mënyrë që të përdoret ai material pa u dëmtuar. Materiali mbahet në tavolinë dhe jo në DUAR.

VENDOSJA NË RAFTE

Vendosja e përshtatshme e librave dhe dokumenteve tjera në rafte është çelës kryesor i ruajtjes së gjendjes së tyre të mirë dhe jetëgjatësisë në përgjithësi. Librat duhet të mbahen në pozitë të drejtë vertikale në rafte, të mbështetura nga librat e tjerë ose mbështetëset e librave (BKUK përdor

mbështetës për përforcimin e pozicionit të librave).

Vendosja e papërshtatshme e librave

Raftet nuk duhet të stërngarkohen (mbushen tepër). Librat duhet të rreshqasin lehtas në rafte pa forcë. Librat e lënë anash ose pjerrët mund të shkaktojnë shtrembërimin dhe deformimin e librit ndërsa lidhjet mund të shpëputen ose prishen. Librat nuk duhet kurrë të vendosen me shpinën lart pasi që pesha e fletëve, herët ose vonë, tërheq bllokun e tekstit nga mbështjellësi (kapakët)



Vendosja e papërshtatshme e librave

dhe e shpëput atë. Kur librat janë renditur papërshtatshëm, lidhjet e bllokut të tekstit, lidhjet e shpinës, dhe mbështjellësit - shpëputen. Palosja mbrapa, kthimi nga ana e prapme e mbështjellësve të librit, jo vetëm që shkakton dëmtimin e mbështjellësve, por, gjithashtu, shkakton edhe shpëputjen e fletëve.

Nëse përmasat e mëdha të materialeve dhe mungesa e rafteve pengon radhitjen vertikale, librat duhet vendosur sipër njëra-tjetrës horizontalisht - por vetëm tri ose katër në një grumbull, duke u kujdesur që librat me dimension të madh të jenë në fund të grumbullit.

Raftet duhet të kenë thellësi të mjaftueshme aq sa tërësisht të mbajnë vëllimet si dhe të mbetet hapësirë mes librave dhe anës së pasme të rafteve në mënyrë që të ketë qarkullim të mjaftueshëm të ajrit.

Broshurat ose pamfletet mund të humben ose dëmtohen lehtë. Nëse vendosen drejt në rafte ato mund të shtrembërohen dhe të shtypen.

Broshurat e vetme (nga një) mund të ruhen në mbështjellës të tejdukshëm polipropileni, në kuti të mbyllura ose si dosje në sirtar. Broshurat me dimensione të ndryshme nuk duhet të ruhen në dosje ose kuti të njëjtë.

Tërheqja e librit nga rafti

Dëmtime të konsiderueshme të materialeve bibliotekare arrihen edhe gjatë tërheqjes jo të mirë nga raftet. Gjatë largimit nga rafti, libri nuk duhet të tërhiqet nga koka ose pjesa e sipërme e shpinës, e cila është e ndjeshme dhe e prirë të priset. Një tërheqje e tillë rezulton me grisje ose shpëputje të shpinës, dhe kështu më pas dobësohet struktura e librit.

Tërheqja joadekuate e librit nga rafti

Tërheqja e librit mund të bëhet duke i shtyrë prapa shpinat e dy librave që gjenden anash, me qëllim të kapjes së



Tërheqja joadekuate e librit nga rafti

shpinës së librit në mes, ose duke shtrirë gishtin përgjatë skajit të sipërm të përparmë të librit dhe duke tërhequr prapa, me qëllim të kapjes me të lehtë të shpinës.

USHQIMI

Ngrënia dhe pirja - kurrë nuk duhet të bëhet afër materialeve bib-



liotekare, ngaqë ato mund ta njollosin letrën dhe të rrisin rrezikun e paraqitjes së insekteve. Ushqimi i derdhur në fletët e librit fshin ose zhdruk tekstin, gjithashtu tërheq insektet dhe kafshët e dëmshme, të cilat prishin të gjitha pjesët e librit.

Pijet e ndryshme dhe uji - gjithashtu, konsiderohen dëmtues të letrës.

Kurrë nuk duhet të lihen njësitë bibliotekare në dysHEME, sepse ato mund të dëmtohen edhe nga pikat më të vogla të ujit ose nga rrjedhjet e vogla. Gjithashtu, libri nuk bën të lihet nën spërkatëset e ujit.

Pirja e duhanit - në afërsi të librave apo ambienteve ku lexohet, mund të ketë pasoja të tmerrshme, ngaqë rrezikon dëmtimin e koleksioneve (duke mos llogaritur edhe jetët e njerëzve). Mjafton vetëm një mosfikje si duhet e cigares që të shkaktojë zjarr të paparashikueshëm.

TRANSPORTI

Dukuri e zakonshme dhe rutinore në biblioteka është edhe bartja e materialeve nga një vend në tjetrin. Kur ndodh ky proces, duhet pasur kujdes sidomos në përzgjedhjen e karrocave të përshtatshme, me qëllim që të reduktohen rëniet dhe prishjet e lidhjeve të librave.

Duhet të mënjanohej bartjet e grumbujve të mëdha të librave, të cilat mund të rrëzohen. Por, nëse kjo është e domosdoshme, atëherë ato mund të mbahen mirë me dy duar, ose karroca të drejtohet nga dy persona. Në disa raste mund të aplikohet paketimi i rehatshëm i librave në pako, që të pengohet lëvizja dhe rrëshqitja, ato duhet vendosur në pozitë të rrafshët (shtrirë) ose me shpinë poshtë ndërsa pjesët (skajet) e përparme të mbeten sipëri.



Mos e stërngarkoni karrocën!

Gjatë transportit, njësitë e ndjeshme (të dobëta) ose ato me pjesë të humbura, duhet të vendosen në zarfe ose kutia. Nëse janë shumë të thyeshme (brishta), së pari duhet të mbështillen me një copë letër dhe të përdoren zarfet me jastëk (mbushje).

SHPREHITË E PËRDORIMIT TË MJETEVE TË NDRYSHME

Është e paevitueshme, shprehia e përdorimit të mjeteve të ndryshme gjatë leximit apo përdorimit të materialeve. Duke përdorur mjete dhe pajisje të ndryshme gjatë punës në zyre apo laboratorë pune, shpesh nuk merret parasysh apo nuk mendohet se ato mund të shkaktojnë dëme të konsiderueshme për letrën dhe librin.

Lapsat dhe ngjyrat - Duhet të eliminohet përdorimi i ngjyrës dhe vulosjes me ngjyrë në materiale, kurdoherë që është e mundur. Ngjyra, veçanërisht stilolapsat me majë shajaku (të ndjeshme), dëmtojnë përgjithmonë fibrat e letrës, ku më pas ajo ngjyrë rrjedh në afërsi të fletës. Kujdes: Ngjyra nuk mund të fshihet nëse bëhet gabim.

Kapëset metalike të letrës - janë shkatërruese për letrën. Këto objekte të mprehta



metali u shkaktojnë dëme të mëdha materialeve letër e në veçanti nëse letra është e vjetër, e butë ose e brishtë (e thyeshme). Kapëset metalike të letrës gjithashtu ndryshken shpejt dhe lënë njolla ndryshku të paevitueshme në letrë. Kapëset e letrës madje mund të lënë edhe gropa dhe gjurmë në letrë të re. Letra nuk duhet të kapet me këto kapëse as përkohësisht (flasim për materiale bibliotekare që arkivohen).

Letra vetë-ngjitëse për shënime - është zgjedhja më e përshtatshme (përdorshme) që është zbuluar rishtas. Ajo shpesh përdoret për komunikim të informatave. Sidoqoftë, ajo nuk funksionon mirë si transportues i informatave sepse ajo lehtë zhvishet ose humb efektin ngjitës gjatë transportimit të materialeve.

Ajo, gjithashtu, dëmton letrën në disa mënyra. Letra vetë-ngjitëse depoziton mbetjet e saja, të cilat tërheqin pluhurin dhe mykun. Ato mbetje mund të tërheqin te fijet e vjetra, letër të butë, të cilat rezultojnë në humbje të tekstit.

Shiritat ngjitës - Nuk ka lloje të shiritave ngjitës, që përdoren në letrë pa shkaktuar dëme në fibrat e saj. Megjithatë, pothuajse të gjithë shiritat ngjitës që ekzistojnë janë përdorur me qëllim të mirë, për të bashkuar apo arnuar fletët dhe mbështjellësit bashkë. Të gjithë përdoruesit e koleksioneve duhet t'i ikin përdorimit të çfarëdolloj të shiritave, përveç nëse ata shiritat ngjitësi janë prodhuar enkas për produkte arkivore. Përveç humbjeve të pjesëve të fletëve, shiriti lë edhe gjurmë të ngjitësit në mbështjellësit e librit.

FOTOKOPIJIMI

Fotokopja konsiderohet ndër shkaktarët e rëndësishëm të dëmtimit të librit apo materialeve. Hapja e librit, duke shtypur shpinën për të kopjuar dy fletë në të njëjtën kohë, dëmton shpinën e librit. Si pasojë e kësaj, fletët do të ndahen (shkoqen) nga lidhja dhe informatat mund të humbin.

Gjithashtu, ekzistojnë disa lloje të materialeve bibliotekare, të cilat janë shumë të ndjeshme dhe nuk duhet t'i nënshtrohen operimeve fotokopjuese,



siç është rasti me artikujt e dëmtuar ose të brishtë (thyeshëm), vëllimet me lidhje fortë të shtrenguar, artikujt e rrallë dhe fotografitë.

Në rastet kur lexuesit bëjnë fotokopje dhe nuk i njohin mirë rregullat e kopjes, ata duhet të mbikëqyren nga stafi i bibliotekës për të parandaluar ndonjë dëmtim eventual. Vlen përmendur se materiali i lënë në aparatën e fotokopjimit do të dëmtohet (prishet) nga nxehtësia.

MIRËMBAJTJA

Bazuar në konceptet e përgjithshme dhe të njohura se mirëmbajtja është preventiva më e mirë për ruajtjen dhe konservimin e koleksioneve me vlerë, në bib-



lioteka, mund të konkludohet se edhe kjo dukuri ka specifika të veta. Për shkak të depërtimit të pluhurit dhe dheut, përmes dritareve - në majë të librave, e më pas edhe ndërmjet fletëve, grimcohet ose dëmtohet letra. Duhet që, së paku një herë në vit, të bëhet pastrimi gjeneral i librave, dokumenteve dhe rafteve. Të gjitha koleksionet duhet të largohen nga raftet dhe të vendosen në karroca.

Pluhuri dhe papastërtitë e tjera duhet të pastrohen me kujdes me thithëse elektrike nga raftet, pastaj të pastrohen me leckë të pastra, dhe pastaj të rivendosen koleksionet sërish, të cilat, gjithashtu, janë pastruar me thithëse pluhuri. Pastrimi bëhet ashtu që me thithëse vakumi fillohet pastrimi nga maja, duke vazhduar tek anët e secilit libër. Para kthimit të librave në raft, duhet pasur kujdes që raftet të jenë plotësisht të terura. Pasi që gjatë këtij procesi koleksionet shumë lehtë mund të dëmtohen. Pastrimi duhet të bëhet duke aplikuar kujdes të teknikat e përdorimit. Nëse koleksionet janë me vlerë, ose janë me lidhje të ndjeshme apo të dëmtuara, ato duhet të pastrohen me maturi vetëm kur është e domosdoshme.

PËRFUNDIMI

Nga e tëra kjo që u tha më lart, konstatohet se edukimi i komunitetit bibliotekar dhe i lexuesve se si të përdorin dhe trajtojnë materialet bibliotekare, është elementi kryesor në ruajtjen e koleksioneve për gjeneratat e ardhshme. Do të jetë e dëshiruar që secili të inkurajohet për të përdorur materialet e tilla me kujdes dhe vëmendje.

Ruajtja e koleksioneve bibliotekare është një detyrë e rëndësishme, që kërkon përkrahjen dhe ndihmën e të gjithëve - të stafit bibliotekar dhe të përdoruesve (lexuesve).

Historija e bibliotekave në Shqipërië

(Ky tekst është marrë nga revista *Hylli i Dritës, Shkodër, Vjeta XIII, XIV - Kallnduer 1937, 1938, dhe botohet në origjinal, pa ndërhyrjen e redaksisë*)

Vjetërsija

Pasi botuam Universitetet e para të Sinisis Ilirike në të ndercmen Revistën Shkodrane Leka, e pashë të udhës për plotësim që të botojë sot Historin e Bibliotekave në Shqipërië që në kohrat më të lashta e gjer më sot, që kështu dal nga dalë të mundet të plotësohet historija e Kollturës në Shqipërië, massi kjo nuk mund të plotësohet vetëm prej një a dy vetash dhe prej një a dy elementesh, po prej shumë shkrimtarësh, gjurmimesh dhe elementeve të ndryshme që do të kën përpjekje me këte thëm, për këte unë sot po bëj fillimin duke shpresuar se të tjerë shkrimtarë më të zot se unë, do të gjurmojnë gjurmat e mija dhe do të vijojnë kërkimet e bo të plotësojnë pas kësaj historin e kullturës në Shqipërië.

Para se të fillojë nga tregimi i historisë së Bibliotekave në Shqipërië e pashë të udhës që të bëj fjalë mbi përgjithësin e tyre.

Përmbledhja dhe ruajtja e prodhimit frymuer të njerzimit u duk e nevojshme për një herë possa (nga vitet e para) u shpik shkrimi. Gërmimet e Babylonës dhe të Ninevisë na sbuluanë përmbledhjet e koleksioneve të para të përmendoreve të shkruara të fjalës, me gjendjen e plithareve (tullave) të pa pjekurave, sipër në të cilat ishin shkruarë tekste të shenjta, tabëlla astronomike, emëra perëndish, përdorëse historike dhe gramatike.

Në Ninevi u gjendën me mijëra nga këto plithare të vendosura në rathë sipër në për dërasa (dhoga), brenda në një dhomë të pallatit të Kujanxhikut, duke përbërë këto bibliotekën e mbretit të Assyrisë Sardhanapalit. Një pjesë e mjaftë (e konsiderushme) prej këtyre plitharve humbi, po shumë mijëra prej tyre gjenden sot të vendosura në Bibliotekën e Muzeumit Britanik në Londër. Këto koleksione shumë të moçme përmbaheshin mbase për për-


dorimin e mbretërve, po gjendeshin edhe koleksione që mbaheshin në për Faltoret. Në Jerussalem për shembëll mbaheshin libra të nomit (kanunit të Moisiut dhe të shkrimeve të shenjta). Në Egjiptë ç'do ndërtes e shenjta ruante libra liturgjike, mjekësore dhe bujqësore.

Po, fjala Bibliotekë që muarën prej helinishtes dhe gjithë gjuhurat e reja Europiane, në kohrat e moçme nuk përdorësh me kuptimin që i apim neve sot; në Lindje dhe më tepër në Egjiptë e përdornin për të treguarë vendin ose depozitën që gjendesh a ishin vendosur arhivet komunale ose administrative një farë depozite ose arhive noterjale dhe për këto lloji depozita epnin emërim biblioteka.

Përdorimi i madh i regjistrimit të pronave në kohë të Impratorisë Romane që filloji në kohë të Augustit dhe vijoi dhe prej trashëgimtareve të tij, lehtësojë shumëzimin dhe shvillimin e themelimit e depozitave e të arhiveve në kryeqytetet e guvernarive të ndryshme, që muarë emërim Biblioteka komunale. Ky emër më pas u shtri edhe në për depot e librave letrare e shkencore. Nderi i krijimit të bibliotekave të vërteta nuk u përket Egjiptianvet po Helinvet, me gjithë që e para ish ajo që për një kohë të gjatë epte landën e duhur për shkrimin, Papirin. Në këte mnyrë mbledhja e parë e librave u bë në

Athin për përdorimin komunal në shekullin e 6 para Krishtit prej Pisistratit, të cilën mbreti i Persisë Kserksi kur hyri në Helladhë e rëmbu dhe e dërgojë në Persi, nga e cila prapë u muarë prej Selefkut Nikatoros u muarë dhe u dorëzua së risht Athiveasvet. Athineu përmend edhe Bibliotekën e Polykratit të Samos si edhe bibliotekat private të Nikokratit të Kypros, të arhondit Euklidhit, të vjershëtorit Pyndar dhe të fillosofit Aristotelit. Prej gjithë këtyre vetëm ajo e Pisistratit duket se ka karakterin e një Biblioteke Komunale ose Botore siç i themi në Shqipëtarët.

Dijetarët në Helladhë dhe në Romë nuk i kujtonin si të nevojshme, veç se pak libra që u duheshin për të fituarë



ato njoftime që u duheshin dhe u dukeshin të mjafta për vendin e tyre dhe për kohën në të cilën rronin.

Bibliotek e shënuarë private si pas Athineut, ish ajo e Nileut në Skipsin e Assisë së Vogël. Ky Nileu ish nxënë (dishepulli) i Aristotelit si dhe ajo e Theofrastit që trashëgojë Bibliotekën e të parit dhe e permbante. Straboni thot se kjo Bibliotek ish e para në llojin e saj. Trashëgimtarët e Nileut duke patur frik prej mbretërve të Pergamos të cilët mblithnin dhe mirnin librat nga çdo vendë që gjinin për bibliotekët e shkëlqyer që formuanë në Pergamo, i fshehën këto libra në për bimca (depozita në dhe) dhe pastaji i shitën të fillosofi peripetik Apelikona. Pak më pas, pas vdekjes së këti Syls e shpuri në romë këte bibliotekë të Nileut e ju shit mbretit t'Egjyptit Ptolemeut Filladhelfit, i cili me librat që kish fituarë vetë në Athinë dhe në Rodho, i dërgojë në Aleksandrië për të begatësuar bibliotekën e famëshme që kish filluarë të krijohet atje.

Biblioteka e Aleksandrisë që ish më e famëshmjia dhe më e shquara dhe më e pasura, u themelua prej Ptolemeut Sotiros (Shpëtimtarit) pas shtytjes të Dhimitër Falireut dhe ish e njohur me emërin I megali Vivliothiqi (Biblioteka e madhe)...

II

Shkenca e bibliografisë sot është tepër e madhe dhe e shvilluarë dhë një pasuri e madhe ka hyrë sot në këtë shkencë sin ë pikpamje të artit tipografikë ashtu dhë në artin tregëtarë të libërshitjes e të bibliofilisë, që neve as koha as mjeti na premtan për të shvilluarë në rreshtat e paka të së nderuarës Revistë që po botojmë këto; me pak fjalë treguamë historinë dhe Bibliotekat Kryesore të Botës së qytetëruarë.

Tani kënduësit e dashur mundt të më pyesin, po neve në Shqipërië a kemi patur no një herë dhe a kemi Biblioteka të organizuara?

Për të hequr ndyshimin e Kënduësve të dashur po përgjigjem, se edhe neve në Shqipëri kemi patur e kemi edhe sot Biblioteka, me gjithë vobekësin t'onë në lamin e diturivet, se vendi i ynë në

kohrat e kaluarë ka qenë djepi i qytetërimit dhe mbesojmë që edhe paskëtaj të behet vendi i ynë shembëll i qytetërimit dhe mbrothësisës, dhe përkëte po përshkruaj këtu më poshtë historin e Bibliotekavet t'ona që në kohrat më të lashta e gjerë në ditët t'ona, duke mbesuarë se me anë të këtyre rradhvet i bejë një shërbim të vogël kulturës s'onë Kombetare, dhe duke kërkuarë ndjesë prej zotërinjvet që u la pa përmendur bibliotekat e tyre si edhe për të metat që munt të ketë kjo vepër e vogël, duke u lutur gjithë qytetevet dhe kënduësve të më lajkërojnë për të metat që do të gjejn si edhe për bibliotekat që nuk do t'i shohin këtu të reshtuara.

Rradhën e Bibliotekavet do t'a mbanjmë pas qytetevet.

KOHA E MOÇME.

Apollonija.

Një nga qytetet e përmenduna dhe të shvilluara të Shqipërisë së moçme dhe historike është edhe qyteti i Apollonisë që në gjendesh në Myzeqe në Prefekturën e Beratit në vendin ku gjendet sot fshati i Pojanit të Fjerit.

Apollonija ungjit shumë lartë në shvillimin e diturisë, artit dhe shkencavet të tjera, po pati një jetë më të shkurtër se simotra e saj Epidamni a Dyrahiumi (Durrësi i sotmë).

Ky qytet në gjasht shekujt e parë rroji në lulëzim dhe në kohë të parë të pushtimit Roman ish si një fener i Ndriçmë në Brigjet e Detit Ion si edhe në Brigjet e përtëjshëm të Sinisisë Italike që lëshojë shkëndijat e saj dhe tërhoqi në gji të tij shumë romanër të shquarë për hirë të mësimt e të diturisë dhe më pas, pas të III a të IV shekull filloji të bjerë nga lulëzimi i saj dhe më në fund të shuhet krejt nga faqja e historisë së qytetevet, duke u banuarë më pas prej disa nomadhësh që formuanë fshatin e sotmë të Pojanit afër Fjerit, ose më mirë të themi i ndërtuarë mbi mbeturinat e qytetit të moçmë.

Apollonija si një qytet i math, i shënuarë dhe tregëtarë ish i bindur në ligjet në terë kohën e rrojtjes së tij dhe kishë shumë ndërtesa të shënuara

botënore siç provohet prej mbeturinavet e kujtimevet të mbetura nërmjet të cillavet përmendet edhe "Gjymnazi" afër të cilit gjendesh burimi i quajtur "Kifisos" e cila gjendet në luginën që sot e quajmë Kalive, ku gjendet një burim dhe mbase do të jetë ay burim i moçmë.

Historija na tregon se Pojani kish institutin ose tembullin më të lartë të diturivet "Gymnazin" ku mësuanë shumë burra të shquarë të vjetërsisë, si Oktavi i përciellurë prej Oratorit Apollodhor Pergaminin, Fillosof Arionin me të birët Dhionisin e Nikanorin e të tjerë.

Tani vjen pyetja në kish Apollonija e moçme no një Bibliotek?

Kësaj pyetje i përgjigjem se Apollonija me të vërtetë zotëronte një Bibliotek për këto arsye: 1) Apollonija ka patur pranë ose më mirë të themi në vendin ku gjendet sot Manastiru i Shëmërisë së Pojanit Urakullin e Apollonit ku ish si fattreguës prifti Eyvini që ish dhe i pari mësues si edhe Pithinë; dhe nga historija dimë që në për Urakullat dhe faltoret vendosesh edhe Biblioteka dhe se librat ishin dhurat të shenjta prej perëndivet dhe viheshin nënë mbrojtjen e tyre. 2) Çdo qytet i vjetërsisë që përbante në gji të tij një Istitut a Tempull të diturivet kish edhe Bibliotek si pjesë të pa ndarë të saj. 3) Në Pojan janë gjendur statue njerzish duke mbajtur libra në për duarë, dhe kjo shënon se në ate vend gjendesh vendi i Bibliotekës, se të vjetrit kishin zakon që Bibliotekat e tyre i sbukuronin me statue të ndryshme burrash të njohur në dije. 4) Në Pojan janë gjendur shumë gurë të shkruar me mbishkrime të ndryshme si sentence, dekret, lavdërime, etëtjera si këto, që shënojnë se në ate qytet kish përparuarë mjaftë diturija.

Palmeri p. 156 na thot: "Sed maxiam adepta est celebritatem quando Iulius Caesar eam dignam iudicavit, ubi institueretur Octavius Caesar.... alumno magnam gloriam sibi jure comparavit. Inde enim colligitur, studia litterarum et praetulit Athenis, Massiliae, et ipsi etiam Romae. Id notius est, quam ut auctoritatibus opus sit.

Bardhyli*

/ vijon në numrin e ardhshëm /

*Bardhyli është pseudonim i Llukë Karafilit (1893 – 1976), studiues dhe historian

Biblioteka në fikSIONET e Borges-it

ADIL OLLURI

Biblioteka si topos dhe temë është bërë kaheër pjesë e shkrimeve letrare të shkrimtarëve eminentë botërorë, ku do t'i veçonim argentinasin Horhe Luis Borges dhe italianin Umberto Eko, të cilët e shndërruan bibliotekën në një nga figurat qendrore në veprat e tyre artistike. Borges, i cili një pjesë të mirë të jetës së tij e kaloi në këndet e Bibliotekës së Buenos-Airesit, ku për një kohë ishte edhe drejtor i saj, e vënë figurën e bibliotekës në qendër, ku së bashku me figurën e labirintit përbëjnë boshtin themelor aksiomatik të këtij autori. Këto dy figura përbëjnë një nga tandemët e tij më domethënëse. Ndërsa, Umberto Eko ngjarjen e romanit të tij "Emri i Trëndafilut" e vendos në një bibliotekë mesjetare. Ai, duke e ndjekur shembullin e Borgesit, i njëson bibliotekën me labirintin, që krahas informacionit të bollshëm semiologjik, ai ndërton edhe një bazament të fuqishëm stilistik dhe narrativ.

H. L. Borges është padyshim një nga shkrimtarët më të rëndësishëm të letërsisë së përbotshme, ai është autor iniciues i letërsisë postmoderne, prej të cilit morën material tematik e formal shumë shkrimtarë të ndryshëm. Ai është një nga shkrimtarët më të lidhur me bibliotekën, madje shpeshherë merret edhe si sinonim, ikonë e saj. Ky autor gjatë tërë krijimtarisë letrare ka shkruar vetëm zhanrin e tregimit, duke e kultivuar atë në nivelin e tij më të lartë estetik, për çka njihet edhe si mjeshtër i këtij zhanri. Ai me mjeshtërinë e tij artistike ka bërë ndryshime të mëdha në letërsi në planin e përgjithshëm botëror, duke e inkuadruar elementin e dokumentaritetit dhe erudicionit, modelin e montazhit, palimpsestit, elemente me të cilat proza e tij lëviz një hap përtej prozës moderne. Në tregimet e përmbledhura në dy librat e tij narrativ "Fiksionet" dhe "Alef", të përmbledhura dhe të botuara nga Rilindja (1981), me një titull të përbashkët "I pavdekshmi", ky autor krahas figurave dhe topo-



Horhe Luis Borges (1899 - 1986)

seve flet edhe për biblioteka, bibliotekistë, katalogë, kënde, gjashtëkëndëshet e bibliotekës së Babilonisë etj. Biblioteka si figurë dhe topos vërehet në shumë tregime të Borgesit, por ajo më së shumti theksohet te "Biblioteka e Babilonisë" dhe "Alef", dy tregime ndër më kryesoret të këtij shkrimtari, si për nga vlera e tyre estetike, po ashtu edhe për nga materiali i tyre tematik.

"BOTA (QË TË TJERËT E QUAJNË BIBLIOTEKË)"

Kështu e fillon Borges tregimin e tij "Biblioteka e Babilonisë", ku qysh në fillim jep një vlerësim personal për bibliotekën duke e krahasuar me botën, jo vetëm duke e krahasuar, por duke e quajtur Botë atë vetë, madje duke e shënuar me shkronja të mëdha për ta shpërfaqur kështu intencën e tij ideore. Pra, biblioteka për të është një botë e

tërë, një hapësirë e pakufishme në aspektin e saj aksiologjik, edhe pse objekti i saj është i kufijshëm, por kjo kufijshmëri e objektit të saj, sipas Borgesit, ekziston për ta mbajtur në vete pakufijshmërinë e saj, gjithnjë duke e pasur parasysh rëndësinë. Këtë ide të tij e përforcon edhe më poshtë, kur thotë se "Biblioteka është globi, mesi i vërtetë i të cilit është cilido gjashtëkëndësh...." Autori e shënon bibliotekën si një instrument me të cilin do të arrihej amshueshmëria e ardhshme e botës, ku përmes saj e kaluara do të jetonte në të ardhmen, ku kohërat mund të ndërroheshin, por do të jetonin gjithmonë të markuara në këtë institucion, më të cilin, sipas tij, do të koekzistonte vetë koha si fenomen. Koha do të konservohej në kthinat gjashtëkëndëshe të bibliotekës së Borgesit. Biblioteka në tregimet e tij jo

vetëm që manifestohet si topos, por ajo me një mënyrë merr edhe funksionin e simbolit që ka domethënie e një rregullimi eternal, të një sistemi universal dhe permanent (të përhershëm).

Në këtë tregim Borgesit rrëfen për bibliotekën e parë që njihet njerëzimi, atë të Babilonisë, ku rrëfëhet për të duke u nisur nga plani i saj arkitektonal e deri te funksioni i saj dhe pozita e bibliotekarit të asaj kohe. Bibliotekari babilonas ishte një personalitet i adhuruar nga njerëzit, këtë gjë e thekson edhe vetë tregimtari: “ ishte një bibliotekarë, që dinte për këtë libër dhe që ishte i ngjashëm me zotin. Në gjuhën e asaj zone, ende kishte gjurmë të adhurimit, që i bëhej këtij nëpunësi të largët”. Aspekti deskriptiv (përshkruar) i Bibliotekës së Babilonisë është ndër pjesët më artistike në mbarë letërsinë botërore, ku ky aspekt i këtij autori ka prodhuar edhe romane të ndryshme botërore. Shembullin më konkret e kemi romanin “Emri i Trëndafilin”, të Umberto Eko, ku autori italian e merr këtë pjesë nga paraardhësi i tij stilistik dhe e ndërton toposin e romanit të tij dhe natyrën e shkrimit, por vetëm se ky i fundit ngjarjen e vendos në mesjetë, për dallim prej argentinastit që subjektin e tij e vendos në antikitet.

Përshkrimi i Bibliotekës së Babilonisë është vetëm një segment për ta krijuar idenë e tij për institucionin e përjetshëm dhe të amshueshëm, ngaqë edhe po të ish fjala për Bibliotekën e Buenos-Airesit, në të cilin ka punuar dhe drejtuar Borgesit, intenca e tij do të ishte prapëseprapë e njëjtë. Pra, ai nuk tregon histori, por e vesh prozën e tij me erudicion dhe dokumentaritet, duke dhënë një dimension të plotë të domethënies së shkrimit të tij. Amshueshmëria e bibliotekës semantike dhe përmbyll shkrimin, duke e vlerësuar atë si një genie eternale. Kjo vërehet përmes kësaj sintgme: “ ... druaj se gjinia njerëzore, - e vetmja që ekziston - është afër fundit të saj, ndërsa Biblioteka do të mbetet e amshueshme”. Me një fjalë ky autor e njësion bibliotekën me hyjnoren.

Megjithatë, Borgesit nuk rrëfen këtu vetëm për kohën e antikitetit babilonas, por ai shpeshherë rikthehet edhe në kohën bashkëkohore, duke e inkadruar edhe veten në tregim, sidomos në



pjesën kur rrëfen për përvijën e tij bibliotekare: “Sikurse gjithë njerëzit e Bibliotekës edhe unë në rininë time udhëtoja; shkoja në pelegrinazh, kërkova ndonjë libër, ndoshta edhe ndonjë katalog mbi katalogët”. Ky autor luan këtu me kohët e rrëfimit, duke e krijuar kështu edhe një kohë eternale (të përjetshme), të tejkoshme të narracionit, ashtu siç është edhe biblioteka, për të cilën shkroi aq shumë ky shkrimtar prozaist.

Tregimi “Alef”, që ka një natyrë të prozës së thellë asociative, e vë në qendër të tij Alefin, që për ne ka kuptimin primar të shkronjës së parë të alfabetit hebraik. Pra, ajo në këtë tregim merr ngjyrë, konotacion, bëhet shenjë letrare, të cilën autori e konfigurion dhe ia jep të njëjtattribute të cilat ia jep bibliotekës, ku mund të theksojmë se Alefi i Borgesit ka identitetin e një simboli, përmes të cilit identifikohet vetë biblioteka. Por, këtë figurë ai e zgjeron, duke i dhënë edhe një vëll të theksuar vizuale, dhe një sipërtheksim të nuancës së tij enciklopedike. Dhe kjo ana e tij vizuale e bën atë që përveç simbolizimit të bibliotekës ta simbolizojë edhe internetin dhe komunikimin e sotëm masiv përmes teknologjisë ultramoderne. Por, pasi që Borgesit ka qenë gjithnjë i lidhur me bibliotekën, mund të lejojmë vetes mundësi që të mendojmë se ai para së gjithash me

këtë figurë ka pasur parasysh bibliotekën. Alefi i Borgesit është një mjet përmes të cilit njeriu mund t'i njohë dhe t'i shohë në një vend të gjitha dijet dhe fenomenet që kanë ndodhur dhe janë duke ndodhur.

“Alefi është një pikë e hapësirës që kap të gjitha të tjerat, që kap të gjithë hapësirën e globit, të shikuar nga të gjitha qoshet”.

Ky është Alefi i shkrimtarit argentinast, përmes të cilit ai i sheh të gjitha pikat e hapësirës, kozmosit, të gjitha burimet e dijes që reflektojnë mbamendjen, kujtesën universale të të gjitha civilizimeve, të gërshetuar në një vend të vetëm. Ky instrument ku unifikohet kjo kujtesë për autorin është një gjithësi e paimagjinueshme, një univers i tërë i unifikuar në një njësi të vetme. Dhe kjo nuk është gjë, pos një idejimi i bibliotekës ultramoderne dhe asaj të digjitalizuar. Pra, këtu i gjithë ligjërimi ka natyrë asociative.

Borgesit është autor që ka ndikuar shumë në rrjedhat e letërsisë botërore, duke i thyer njëkohësisht rrjedhat e letërsisë, duke kaluar kështu nga modernizmi në postmodernizëm. Ai është një autor me të cilin, siç e thamë më lart, shpeshherë edhe identifikohet vetë biblioteka, si institucion që mbledh dijen gjenerale në një vend për t'ua servuar atë lexuesve.

Aftësimi në teknologjinë e Kodit të Sigurisë së Librit

Prishtinë, 12-16 nëntor 2007

Në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, më 12-16 nëntor, qëndroi Marc Mingard, ekspert nga BIBLIOTECHA RFID Library System AG, me seli në Cyrih të Zvicrës.

Gjatë qëndrimit të tij pesëditor, Mingard bëri instalimin e stacioneve vetëshërbyese të Kodit të Sigurisë së Librit, si dhe instalimin e portave siguruese të librit. Në këtë kohë, janë përkthyer dhe janë vënë në funksion meny të këtij sistemi, në mënyrë që përdoruesit (lexuesit) shqiptarë në BKUK t'i mundësohet që me lehtësi t'i përdorë këto 'stacione' për të kryer shërbimin e huazimit të librit.

Z. Mingard, gjithashtu, ka mbajtur trajnime për të përgatitur stafin e BKUK-së për përdorimin e Kodit të Sigurisë, duke filluar nga përpunimi i librit - se si vihet kodi i sigurisë, e deri te deaktivizimi i alarmit në portat siguruese.



Marc Mingard, në BKUK, në njërin nga seancat e trajnimit për RFID

PROJEKTI OSBE-së PËR PAJISJE DHE MENAXHIM TË RESURSEVE FIZIKE DHE DIGJITALE TË BIBLIOTEKËS

I. TRAJNIM NË PROGRAMIN ALEPH 500



Prishtinë, 12 - 16 nëntor 2007

Në kuadër të Projektit të OSBE-së i Departamentit për Qeverisje të Mirë dhe Institucione Demokratike - Njësia për Arsimim të Lartë, ka qëndruar në BKUK - Alan Oliver, ekspert nga kompania ExLibris. Oliver ka udhëhequr trajnimet e stafit të BKUK-së në modulet e Pasurimit dhe të Qarkullimit të Programit të integruar bibliotekar Aleph 500 - produkt i kompanisë ExLibris.

Bibliotekarët e Departamenteve të Pasurimit dhe të Qarkullimit gjatë këtyre ditëve të trajnimit kanë arritur të përfitojnë njohuri shtesë, duke qartësuar probleme që janë pjesë e proceseve të punës së përditshme në këto module.

II. ENVISIONWARE PC - NË BKUK

Prishtinë, 7 - 9 nëntor 2007

Në kuadër të po këtij Projektit të OSBE-së, për përmirësimin e cilësisë në BKUK, ka qëndruar Barry Cannon, ekspert i teknologjisë informative, i cili bëri instalimin e programit Envisionware PC. Sistemi i këtij programi mundëson që në mënyrë automatike të kontrollohet rezervimi i kompjuterëve nga përdoruesit, në mënyrë që t'i jepet atij qasje e kontrolluar (e afatizuar në kohë), për aq sa lejohet në kushte dhe rrethana ku kërkesat për qasje në burimet elektronike, siç janë në BKUK, janë të mëdha.

III. ATHENS - PËR PËRDORUESIT ME TË DREJTË QASJEJE NË BURIMET ELEKTRONIKE

Prishtinë, 11 - 12 dhjetor 2007

Në kuadër të Projektit të OSBE-së për përmirësimin e cilësisë në BKUK, gjithashtu është instaluar Programi Athens (për shërbimet me parapagim) për t'iu qasur koleksioneve dhe burimeve elektronike që ofron kjo bibliotekë.

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, nëpërmjet Sistemit menaxhues për qasje në Athens, do të vejë kontroll dhe të lejojë qasje në burimet elektronike për përdoruesit me të drejtë qasjeje në burimet elektronike që ofron biblioteka. Nëpërmjet këtij kontrolli, Athens, njëkohësisht, bën menaxhimin e përdoruesve në burimet elektronike, jo vetëm brenda, por edhe jashtë bibliotekës.

Me këtë, BKUK do të mundësojë që profesorët dhe asistentët e Universitetit Publik të Prishtinës, si dhe doktorantët dhe studentët që studiojnë master në Kosovë të kenë qasje në burime elektronike nga distanca: shtëpia, puna, universiteti ku studion etj.

Në BKUK - u inaugurova Biblioteka Evropiane

Prishtinë, 6 dhjetor 2007

Në BKUK është bërë inaugurimi i Bibliotekës Evropiane të Kosovës.

Hapja e kësaj biblioteke është mundësuar nga Ministria e Jashtme e Gjermanisë dhe Pakti për Stabilitetin e Evropës Juglindore.

Biblioteka Evropiane në fondin e saj ka mbi 1500 tituj materialesh të fushave dhe interesimeve të ndryshme.

Të pranishëm në këtë manifestim ishin përfaqësues të rëndësishëm të jetës politike e kulturore të Kosovës, si dhe studiues dhe studentë të Universitetit të Prishtinës.

Inaugurimin e kësaj biblioteke e përshëndeti - drejtori i BKUK-së, dr. Sali Bashota, i cili ka falënderuar donatorët dhe përkrasit për hapjen



e kësaj biblioteke, duke e konsideruar këtë bibliotekë si ngjarje e rëndësishme në fushën e integritimit kulturor të Kosovës në Bashkimin Evropian.

Ndërkaq, shefi i Zyrës Ndërlidhëse të Gjermanisë, Karl Wokalek, pas falënderimit që i ka bërë Qeverinë gjermane dhe në veçanti Paktit të Stabilitetit për

Evropën Juglindore, ka theksuar se Biblioteka Evropiane do t'u japë mundësi studentëve e hulumtuesve që të njihen me politikën evropiane: me kulturën, me çështjet ligjore, me çështjet ekonomike etj..

Hapjen e kësaj biblioteke e ka përshëndetur edhe kryetari i Iniciativës Evropiane të Kosovës - Beqë Cufaj.

Me rastin e inaugurimit të Bibliotekës Evropiane, është bërë edhe nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit mes: Iniciativës Evropiane të Kosovës, Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës dhe Zyrës Ndërlidhëse të Gjermanisë, si dhe është promovuar periodiku në gjuhën shqipe: "Evropa - revistë për shtëpinë e për-bashkët".

Manifestimi - Zgjedhja e Lexuesit të Vitit, në Bibliotekën "Hivzi Sulejmani"

Prishtinë, 27 dhjetor 2007

Biblioteka Ndërkomunale "Hivzi Sulejmani" në Prishtinë, më 27 dhjetor 2007, organizoi manifestimin tashmë tradicional Zgjedhja e Lexuesit të Vitit.

Në këtë manifestim morën pjesë përfaqësues të institucioneve qeveritare dhe kulturore, shkrimtarë, bibliotekarë, si dhe dashamirë të bibliotekës e të librit.

Manifestimin e ka përshëndetur - Sylejman Pireva, drejtor i BN "Hivzi Sulejmani" të Prishtinës. Drejtori Pireva, për përkrasje institucionale dhënë bibliotekës "Hivzi Sulejmani, ka nderuar me mirënjohje - Mustafë Halilin, drejtor i Drejtoratit për Kulturë dhe Gjini në Komunën e Prishtinës, ndërsa për ndihmë në pasurimin e koleksioneve - shkrimtarin e njohur Jusuf Buxhovi, dhe Shtypshkronjën "Verona".

Me mirënjohje - punëtor i dalluar, është nderuar Veli Veliu, bibliotekar.

Biblioteka përmbylli këtë manifestim, tashmë tradicional, me ndarje të shpërblimeve për lexuesit e dalluar: Lundrim Luga nga SHF "Elena Gjika", Gresa Zeka nga SHF "Faik Konica", Erion Halimi nga dega "Përralla", Liron Morina nga dega "Lektura". Ndërsa nga sektori për të rritur Visare Beqiri dhe Basri Gashi Gjithashtu u publikuan edhe titujt më të lexuar gjatë vitit 2007.

Manifestim për Ditën e Bibliotekës Ndërkomunale në Prizrenit

Prizren, 27 dhjetor 2007

Biblioteka Ndërkomunale e Prizrenit, më 27 dhjetor 2007, shënoi 63-vjetorin e themelimit. Në këtë manifestim morën pjesë përfaqësues të rëndësishëm të kulturës dhe të institucioneve të Kosovës. Manifestimi është hapur nga Sahadete Sadikaj, drejtoreshë e Bibliotekës Ndërkomunale të Prizrenit, e cila ka referuar për historikun dhe të arriturat e këtij institucioni.

Këtë manifestim e përshëndetën edhe dr. Salih Bashota, drejtor i BKUK-së, si dhe Elgyn Kyroll, zëvendësministër i Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Çështjeve Jorezidenciale.

Gjatë këtij manifestimi u shfaq program artistik, si dhe u promovua përmbledhja me poezi të zgjedhura nga autorë moshash të ndryshme "Ndize dritën e mendimit", e botuar nga kjo bibliotekë. Gjithashtu, u dhanë shpërblime për lexuesin e dalluar, punëtorin e dalluar, si dhe për dhuruesit që ndihmuan pasurimin e koleksioneve të kësaj biblioteke.

Përgatiti: Bukurije Haliti

KATALOGU I DISERTACIONEVE TË DOKTORATAVE: 1999 - 2004, BKUK, PRISHTINË 2007

Spektori i Qendrës për Informata Shkencore dhe Veprimtari Referale, i cili funksionon në kuadër të BKUK-së, në vazhdim e punëve dhe detyrave që dalin nga kjo Qendër, përgatiti edhe një botim të veçantë mbi disertacionet e doktoratave me titull: Katalog i disertacioneve të doktoratave: 1999-2004.

Ky botim përmban disertacionet e mbrojtura në Universitetin e Prishtinës gjatë periudhës kohore 1999 - 2004, të cilat ruhen në fondet e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Sa për informim, duhet të theksohet se në vitin 1982 kjo Qendër ka përgatitur dhe botuar Bibliografinë e Disertacioneve të doktoratave të doktorëve të shkencave të Kosovës për periudhën kohore 1947 - 1982.

Për qëllime praktike, Katalogu i disertacioneve të doktoratave: 1999 - 2004, është organizuar në tri pjesë. Pjesa e parë përmban shënimet e përgjithshme të disertacionit; pjesa e dytë indeksin e fjalëve çelës (sipas Key World In Context), apo siç quhet tani klasifikimin lëndor; kurse pjesa e tretë përmban indeksin e regjistrimit sipas lëmvive, atë kronologjik, alfabetik - i kandidatëve.

Që të jenë edhe me shumë në funksion të përdoruesve, i tëri ky katalog është edhe në katalogun elektronik të BKUK-së, ALEPH 500, në: <http://www.biblioteka-ks.org/Katalogu.php>

**DORACAK PËR PËRDORUES: NUMRI STANDARD NDËRKOMBËTAR I MUZIKËS - ISMN, BKUK, PRISHTINË 2007.**

Doracak për përdorues: Numri Standard Ndërkombëtar i Muzikës, është doracaku i tretë me radhë i përkthyer nga gjuha angleze në atë shqipe nga Besim J. Kokollari dhe botuar nga BKUK-ja, e cila ka të bëjë me një numër identifikues për koleksionet e muzikës, e që ka filluar të funksionojë edhe në BKUK. Doracaku është një udhëzues, i cili u shërben botuesve të cilët janë të specializuar për muzikë dhe punonjëseve bibliotekarë të cilët merren me përpunimin e këtyre materialeve. ISMN-ja do të ishte identifikuesi ideal për materialet në internet, pasi është në përputhje me shumicën e sistemeve të specializuara identifikuese.

Ky udhëzues përmban hyrjen, historikun dhe disa kapituj të tjerë në mesin e të cilëve janë të dhëna për përdorimin e ISMN-së, elementet dalluese të ISMN-së dhe standarde të tjera, siç janë: ISBN-ja, ISSN-ja dhe ISRC-ja; elementet identifikuese të botuesit, njësisë; fushëveprimi i ISMN-së, format e ndryshme të këtyre materialeve, shtypja dhe reklamimi i ISMN-së, publikimi etj. Në fund, doracaku përmban disa udhëzime për prodhuesit e etiketave të barkodeve.

SEKTORI I MUZIKËS: NUMRI STANDARD NDËRKOMBËTAR I MUZIKËS, BKUK, PRISHTINË 2007.

Në ndihmë të botuesve dhe për qëllime praktike, Spektori i Muzikës pranë BKUK-së, ka botuar edhe një fletushkë mbi ISMN. Kjo fletushkë përmban vetëm të dhënat elementare për përdorimin e ISMN-së. Në mënyrë të veçantë, këtu janë prezantuar llojet e materialeve që duhet të marrin numrin e ISMN-së, siç janë: partiturat, partiturat miniaturë, partiturat vokale, pop folio-t, antologjitë e partiturave, tekstet e këngëve ose lirikat e botuara me vepra muzikore, librat e këngëve (opcionale), veprat muzikore braille, veprat muzikore elektronike, etj.

Në kuadër të këtyre udhëzime ofrohen edhe njoftime mbi ato lloje botimesh që nuk marrin ISMN-në; si dhe mbi vendin se ku duhet marrë ISMN-ja, pra me BKUK-në si vend ku duhet të drejtohen botuesit e Kosovës.

**UDHËZUES (PËR PËRDORIMIN E BURIMEVE ELEKTRONIKE), BKUK, PRISHTINË 2007**

Ky udhëzues është përgatitur me qëllim që përdoruesit e bibliotekave të kenë lehtësi për t'u qasur në bazat e të dhënave elektronike, të cilat i ofron Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës përmes Konsorciumit të Bibliotekave Elektronike.

Pra, udhëzuesi është përgatitur pas sigurimit të burimeve elektronike - qasjes në bazat e të dhënave: EBSCO dhe GALE, të siguruar nga granti për këto burime i Zyrës Amerikane në Prishtinë, si dhe të ndihmës së OSBE, për sigurimin në bazat e të dhënave: OXFORD JOURNALS dhe OXFORD SCHOLARSHIP ONLINE.

Këto burime në internet, ofrojnë për përdoruesin në Kosovë, veçanërisht për përdoruesit në BKUK, një sasi të konsiderueshme të të dhënave bibliografike dhe me tekst të plotë, që plotësojnë nevojat për informim në të gjitha fushat e kërkua dhe që janë sot domosdoshmëri në tërë rrjetin e informacionit botëror bibliotekar.

Gjon Berisha